

Raporti i Monitorimit të RAP për Kosovën

ZHVILLIMI DHE KOORDINIMI I POLITIKAVE

2024/2025



Group for Legal
and Political
Studies



Publikimi:

**Raporti i Monitorimit të RAP për Kosovën
Zhvillimi Dhe Koordinimi i Politikave 2024/2025**

Publikuesi:

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS)

Autorët:

**Blerina Istrefi,
Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Prishtinë
Elona Kurti,
Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Prishtinë**

Dizajn:

2vo

Përmbajtja:

	Autorët	2
	Rreth Weber 3.0	4
	Falënderime	5
	Përmbledhja Ekzekutive	6
	Lista e Shkurtesave dhe Akronimeve	8
I.	Monitorimi i RAP-it WeBER: Çfarë monitorojmë dhe si?	9
	I.1 Qasja e WeBER-it ndaj monitorimit të RAP	9
	I.2 Pse dhe si WeBER monitoron fushën “Zhvillimi dhe Koordinimi i Politikave”	10
II.	Transparenca dhe Gjithëpërfshirja në Zhvillimin dhe Koordinimin e Politikave	17
	II.1 Transparenca dhe gjithëpërfshirja e procesit të vendimarrjes qeveritare	17
	Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?	19
	II.2 Transparenca e planifikimit dhe raportimit qeveritar	19
	Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?	24
	II.3 Transparenca dhe gjithëpërfshirja e procesit të hartimit të politikave dhe zhvillimit të legjislacionit	24
	Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?	29
	II.4 Transparenca dhe gjithëpërfshirja e zbatimit të politikave, vlerësimit dhe mbikëqyrjes parlamentare	30
	Si qëndron Kosova në aspektin rajonal	32
	Krahasimi i pikëve të përgjithshme në fushën e Zhvillimit dhe Koordinimit të Politikave	33
	II.5 Rekomandime për fushën e Zhvillimit dhe Koordinimit të Politikave	34
	II.5.1 Ndjekja e rekomandimeve nga Monitori i RAP-it 2021/2022	34
	II.5.2 Rekomandimet nga Raporti Monitorues 2024/2025	35
	Shtojca e Metodologjisë	37
	Lista e Burimeve të Referuara në këtë Raport	43

RRETH WEBER 3.0

Duke u mbështetur në arritjet e projekteve të kaluara, WeBER (2015–2018) dhe WeBER 2.0 (2019–2023), projekti Western Balkan Enablers for Reforming Public Administrations – WeBER 3.0 është granti i tretë radhazi i financuar nga BE-ja në kuadër të iniciativës më të madhe të udhëhequr nga shoqëria civile për monitorimin e reformës së administratës publike (RAP) në Ballkanin Perëndimor. Periudha e zbatimit të tij është nga shkurti 2023 deri në korrik 2026. I udhëhequr nga Parimet e SIGMA/OECD, dy fazat e para të iniciativës hodhën themelet për ambicien e WeBER 3.0 që të fuqizojë më tej organizatat e shoqërisë civile (OSHC) për të kontribuar në administrata më transparente, më të hapura, më llogaridhënëse, më të orientuara ndaj qytetarëve dhe, rrjedhimisht, më të përputhshme me standardet e BE-së në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

WeBER 3.0 vazhdon të promovojë rolin thelbësor të OSHC-ve në RAP, duke avokuar gjithashtu për përfshirje më të gjerë të qytetarëve në këtë proces dhe për masa reformuese gjithëpërfshirëse, të përshtatura sipas nevojave të përdoruesve dhe që sjellin përmirësime të prekshme. Duke i mbështetur veprimet në të dhëna dhe analiza të fuqishme monitorimi, WeBER 3.0 do të fuqizojë shoqërinë civile që të ndikojë më efektivisht në hartimin dhe zbatimin e RAP-it. Për të nxitur hartimin bashkëpunues të politikave dhe për të ngushtuar hendekun ndërmjet aspiratave dhe zgjidhjeve të zbatueshme, projekti do të lehtësojë dialogun e qëndrueshëm politik ndërmjet qeverive dhe OSHC-ve përmes Platformës WeBER dhe Grupeve Kombëtare të Punës për RAP. Në fund, përmes granteve të vogla për OSHC-të lokale, WeBER 3.0 forcon angazhimin në RAP në nivel lokal, duke fuqizuar zërin e qytetarëve – përfituesve përfundimtarë të punës së administratës publike.

Produktet e WeBER 3.0 dhe informata të mëtejshme rreth tyre janë të disponueshme në faqen e projektit në www.par-monitor.org.

WeBER 3.0 zbatohet nga Think for Europe Network (TEN), i përbërë nga gjashtë institute kërkimore ("think tanks") të orientuara drejt politikave të BE-së në Ballkanin Perëndimor.

Përmes partneritetit me Centre for Public Administration Research (KDZ) nga Vjena, WeBER 3.0 ka siguruar dukshmëri në nivel të Bashkimit Evropian.

FALËNDERIME

Sikurse në rastin e edicioneve të mëparshme të raporteve kombëtare të Monitorimit të RAP-it, të publikuara për vitet 2017/2018, 2019/2020 dhe 2021/2022, mirënjohje të veçantë u shkon anëtarëve të Platformës WeBER dhe Grupit Kombëtar të Punës në Kosovë, si dhe palëve të tjera të interesit në Kosovë që ndanë përvojat e tyre përmes intervistave, duke kontribuar jashtëzakonisht në cilësinë e këtij raporti. Ata nuk janë identifikuar individualisht në këtë raport, me qëllim të mbrojtjes së anonimitetit të tyre.

Ekipi i WeBER 3.0 dëshiron gjithashtu të falënderojë partnerët dhe bashkëpunëtorët kryesorë, të cilët kanë mbështetur projektin në hulumtim dhe aktivitete të tjera. Veçanërisht, këta janë SIGMA/OECD¹, ReSPA, si dhe Zyra e Kryeministrit dhe Kuvendi i Kosovës, në cilësinë e bashkëpunëtorit të projektit.

1 Një iniciativë e përbashkët e Bashkimit Evropian dhe OECD-së.

Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport vlerëson transparencën dhe gjithëpërfshirjen e katër aspekteve të zhvillimit dhe koordinimit të politikave: 1.) transparencën dhe gjithëpërfshirjen e procesit të vendimmarrjes qeveritare, 2.) transparencën e planifikimit dhe raportimit qeveritar, 3.) transparencën dhe gjithëpërfshirjen e procesit të hartimit të politikave dhe zhvillimit të legjislationit, dhe 4.) transparencën dhe gjithëpërfshirjen e zbatimit të politikave, vlerësimit dhe mbikëqyrjes parlamentare. Aspekti i parë shqyrton nëse transparenca në vendimmarrjen qeveritare sigurohet përmes angazhimeve strategjike, dispozitave ligjore dhe publikimit sistematik të informatave nga mbledhjet e qeverisë. Aspekti i dytë analizon nëse obligimet e qeverisë për planifikim dhe raportim janë të rregulluara, si dhe nëse dokumentet përkatëse publikohen me kohë, janë të orientuara drejt performancës dhe të qasshme në formate të hapura. Aspekti i tretë vlerëson nëse hartimi i politikave dhe zhvillimi i legjislationit janë transparente, gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në dëshmi-duke përfshirë pjesëmarrjen e palëve të interesit, vlerësimet e ndikimit, raportimin dhe mbikëqyrjen e konsultimeve, si dhe ndikimin e kontributit publik në vendimet përfundimtare. Aspekti i katërt shqyrton mekanizmat ligjorë dhe praktikë për njoftimin paraprak, publikimin e raporteve të monitorimit dhe vlerësimit paraprak, si dhe përfshirjen e palëve të interesit në mbikëqyrjen parlamentare. Gjetjet mbulojnë periudhën nga viti 2023 deri në vitin 2025, si dhe zhvillimet e fundit të vitit 2022 që nuk janë përfshirë në ciklin paraprak.

Në këtë fushë monitorimi të Reformës së Administratës Publike, aspekti i koordinimit dhe zhvillimit të politikave në Kosovë vlerësohet në aspekt të transparencës dhe gjithëpërfshirjes në procesin e vendimmarrjes (sub-indikatori 1), në planifikimin dhe raportimin qeveritar (sub-indikatori 2), në procesin e hartimit të politikave dhe zhvillimit të legjislationit (sub-indikatori 3), si dhe në zbatimin e politikave, vlerësimin dhe mbikëqyrjen parlamentare (sub-indikatori 4). Përmirësimet strategjike drejt transparencës parashihen vetëm për procesin e hartimit të politikave dhe zhvillimit të legjislationit, ndërsa përmirësime në gjithëpërfshirje nuk parashihen në asnjërin nga sub-indikatorët.

Sa i përket procesit të vendimmarrjes, Rregullorja e Punës së Qeverisë përcakton se qeveria duhet të publikojë vendimet që dalin nga secila mbledhje e qeverisë, dhe në praktikë kjo respektohet mirë. Në përqindje, 100% e 58 vendimeve të marra gjatë 13 mbledhjeve të vëzhguara të qeverisë janë publikuar me kohë në Gazeten Zyrtare. Ndërkohë, rregulloret nuk kërkojnë në mënyrë të shprehur publikimin e rendit të ditës, procesverbaleve të mbledhjeve apo komunikatave për media. Nga gjithsej 9 pikë, ky sub-indikator ka marrë 4 pikë.

Sa i përket planifikimit dhe raportimit qeveritar, Ligji për Qeverinë e obligon Qeverinë të publikojë dokumente planifikuese si programet dhe planet vjetore të punës. Planet vjetore të punës së Qeverisë publikohen me kohë dhe në mënyrë të kuptueshme për qytetarët, si dhe përmbajnë indikatorë të qartë të performancës për monitorim më të mirë të arritjeve. Fatkeqësisht, Ligji nuk kërkon publikimin e raporteve të zbatimit për këto dokumente, prandaj asnjë raport i tillë nuk vihet në dispozicion të publikut dhe nuk mund të vlerësohet në mënyrë të duhur. Nga gjithsej 20 pikë, ky sub-indikator ka marrë 3.50 pikë.

Vlerësimi i duhur i zhvillimit të legjislacionit është penguar nga viti pasiv që pati Kosova në vitin 2025 për shkak të mungesës së Qeverisë dhe Kuvendit funksional, pasi mandati i tyre kishte përfunduar në shkurt 2025 dhe institucionet e reja nuk u zgjodhën deri në shkurt 2026. Megjithatë, Qeveria funksionoi si qeveri në detyrë me përgjegjësi të kufizuara dhe ishte në gjendje të miratonte dokumente politikash. Rregullorja e Punës së Qeverisë rregullon procesin e konsultimit për dokumentet e politikave, si dhe për legjislacionin primar dhe sekondar, duke përcaktuar kohëzgjatjen minimale prej 15 ditësh, afatet për informimin e palëve të interesit, dokumentet që duhet të publikohen, formatet e konsultimit dhe publikimin e raporteve përfundimtare të konsultimeve. Raportet paraprake për dokumentet e politikave përgatiten në formën e koncept-dokumenteve, të cilat pasohen nga konsultimet publike dhe më pas nga raportet përfundimtare. Nga gjithsej 52 pikë, ky sub-indikator ka marrë 16.5 pikë.

Në fund, sa i përket zbatimit të politikave, vlerësimi dhe mbikëqyrjes parlamentare, rregulloret përcaktojnë se dëgjimet publike për legjislacionin duhet të përfshijnë shoqërinë civile dhe palët e tjera të interesit. Megjithatë, meqenëse gjatë periudhës së monitorimit nuk është miratuar asnjë ligj, elementet praktike lidhur me legjislacionin janë vlerësuar negativisht. Nga gjithsej 19 pikë, ky sub-indikator ka marrë 1.75 pikë.

Lista e Shkurtesave dhe Akronimeve

SRAP – Strategjia për Reformën e Administratës Publike

PKZH – Plani Kombëtar i Zhvillimit

QDP – Qasja në Dokumente Publike

IK – Informatorët Kyç

RAP – Reforma e Administratës Publike

PPZBA – Programi për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative

RoP – Rregullorja e Punës

ReSPA – Shkolla Rajonale e Administratës Publike

SIGMA – Mbështetja për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit

TEN – Rrjeti Think for Europe

WeBER – Projekti i Ballkanit Perëndimor për Mundësimin e Monitorimit të Reformës së Administratës Publike nga Shoqëria Civile

I. Monitorimi i RAP WeBER: Çfarë monitorojmë dhe si?

I.1 Qasja e WeBER-it ndaj monitorimit të Reformës së Administratës Publike (RAP)

Metodologjia e Monitorimit të Reformës së Administratës Publike (RAP) është zhvilluar gjatë viteve 2015-2016, në kuadër të projektit të parë WeBER. Që nga fillimi, WeBER ka ndjekur një qasje të theksuar të bazuar në dëshmi, me synim rritjen e relevancës, pjesëmarrjes dhe kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile (OShC) në Ballkanin Perëndimor për të avokuar dhe ndikuar në hartimin dhe zbatimin e Reformës së Administratës Publike (RAP). Metodologjia e Monitorimit të RAP-it përbën një nga produktet kryesore të WeBER-it, duke mundësuar monitorimin e RAP-it nga shoqëria civile mbi bazën e dëshmive dhe analizës.

Në përputhje me fokusin e WeBER-it në procesin e integritetit evropian të rajonit, pas rishikimit të Parimeve të Administratës Publike të SIGMA në vitin 2023, metodologjia e Monitorimit të Reformës së Administratës Publike (RAP) të WeBER-it u ridizajnuar gjithashtu në vitin 2024, duke u bazuar në këto Parime² dhe në metodologjinë e SIGMA-s,³ si dhe duke plotësuar monitorimin e SIGMA-s përmes ofrimit të vëzhgimeve shtesë të fokusuara në transparencë, gjithëpërfshirje, qasje të hapur dhe aspekte të tjera të funksionimit të administratës shtetërore, varësisht nga fusha përkatëse e RAP-it. Ky rishikim ndihmon në ruajtjen e fokusit të rekomandimeve të WeBER-it drejt reformave në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, duke udhëzuar kështu qeveritë e rajonit drejt integritetit të suksesshëm evropian dhe anëtarësisht të ardhshëm në BE. Ndryshimet kryesore në metodologjinë e rishikuar të Monitorimit të RAP-it janë paraqitur shkurtimisht më poshtë.⁴

Tabela 1. Ndryshimet kryesore në metodologjinë e Monitorimit të RAP-it

Struktura

Për të harmonizuar metodologjinë me qasjen e re metodologjike të SIGMA, janë prezantuar ndryshimet e mëposhtme strukturore:

- Prezantimi i një indikatori të vetëm për secilën fushë të Reformës së Administratës Publike (RAP), i ndarë në nënindikatorë, të cilët më tej përbëhen nga disa elemente të nënindikatorëve (pra, kriteret specifike të vlerësimit), me qëllim të thjeshtimit të qasjes dhe theksimit të fokusit në transparencë, gjithëpërfshirje dhe qasje të hapur në secilën fushë të RAP-it.

2 OECD (2023), Parimet e Administratës Publike, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/7f5ec453-en>.

3 E disponueshme: <https://www.sigmaweb.org/en/publications/documents/2024/assessment-methodology-of-the-principles-of-public-administration.html>.

4 Për informacione më të detajuara mbi fushëveprimin dhe procesin e rishikimit të metodologjisë vizitoni: <https://www.par-monitor.org/par-monitor-methodology/>.

- Prezantimi i llojeve të elementeve të nënindikatorëve, duke siguruar që të mbulohen të gjitha aspektet e mëposhtme të reformës:
- Strategjia dhe Politikat,
- Legjislacioni,
- Organizimi Institucional,
- Praktika e Zbatimit, dhe
- Rezultatet dhe Ndikimi.

Prezantimi i një shkalle vlerësimi prej 100 pikësh, për të mundësuar një vlerësim më të detajuar dhe më të nuancuar të progresit në secilën fushë të Reformës së Administratës Publike (RAP).

Burimet e Informacionit

- Prezantimi i intervistave me “informatorë kyç”, pra akterë kryesorë jo-shtetërorë të angazhuar dhe të njohur me proceset. Këto intervista shërbejnë si burim i të dhënave për elementet “Rezultatet dhe Ndikimi”, në vend të anketës së organizatave të shoqërisë civile që është përdorur më parë.
- Përdorimi më sistematik i rezultateve të anketave mbi perceptimin publik si burim i të dhënave për elementet “Rezultatet dhe Ndikimi”, si dhe zgjerimi i fushëveprimit të anketës për të plotësuar vlerësimin në pesë fusha të Reformës së Administratës Publike (RAP) – të gjitha, përveç “Strategjisë për RAP”.
- Heqja e anketës së shërbyesve civilë si burim i të dhënave, për shkak të problemeve të vazhdueshme në sigurimin e një niveli të përshtatshëm të përgjigjeve në administratat e rajonit.

Raportimi i Monitorimit të Reformës së Administratës Publike (RAP)

- Gjashtë raporte kombëtare të Monitorimit të Reformës së Administratës Publike (RAP), një për secilën fushë të RAP-it (36 gjithsej për të gjithë Monitorimin e RAP-it), me qëllim të lehtësimit të publikimit me kohë dhe avokimit për rezultatet e monitorimit, në vend që rezultatet e 18 muajve kërkim të publikohen vetëm në fund të procesit.
- Gjashtë raporte rajonale përmbledhëse për Ballkanin Perëndimor, një për secilën fushë të RAP-it (6 gjithsej).

I.2 Pse dhe si WeBER monitoron fushën e “Hartimit dhe Koordinimit të Politikave”

Pjesëmarrja kuptimplotë e qytetarëve në proceset e politikëbërjes përfaqëson një shtyllë themelore të qeverisjes së mirë, duke siguruar që vendimet të pasqyrojnë nevojat reale të shoqërisë, të zhvillohen përmes dialogut me të gjithë palët e interesit dhe grupet e prekura, si dhe t'i nënshtrohen shqyrtimit publik. Politikat e hartuara përmes një qasjeje të hapur dhe transparente janë më legjitime, më të informuara dhe të bazuara në dëshmi, si dhe kanë më shumë gjasa të zbatohen në mënyrë efektive. Planifikimi luan një rol kyç mundësues në këtë proces. Kur qeveritë miratojnë, publikojnë dhe raportojnë mbi dokumentet planifikuese, ato krijojnë parashikueshmëri, u mundësojnë palëve të interesit të angazhohen në kohë dhe krijojnë bazë për të vlerësuar nëse vendimet janë në përputhje me objektivat strategjike të deklaruara. Prandaj, monitorimi i WeBER fokusohet në transparencën dhe gjithëpërfshirjen e elementeve kyçe të ciklit të politikave: nga planifikimi dhe vendimmarrja qeveritare, zhvillimi i

politikave, deri te zbatimi dhe vlerësimi i politikave, dhe në fund, mbikëqyrja parlamentare. Duke vlerësuar këto faza të ndërlidhura, monitorimi shqyrton mënyrën se si parimet kryesore të qeverisjes së mirë reflektohen në praktikën e përditshme të administratës publike, dhe ofron njohuri mbi mënyrën se si qeveritë e Ballkanit Perëndimor komunikojnë vendimet e tyre me publikun, si dhe në çfarë mase zëri i qytetarëve dëgjohej gjatë marrjes së vendimeve kyçe.

Monitorimi në fushën e Hartimit dhe Koordinimit të Politikave bazohet në të gjashtë Parimet e SIGMA në këtë fushë:

Parimi 2: Politikat publike janë koherente dhe koordinohen në mënyrë efektive nga qendra e qeverisë; vendimet përgatiten dhe komunikohen në mënyrë të qartë dhe transparente.

Parimi 3: Qeveria planifikon dhe monitoron politikat publike në mënyrë efektive dhe gjithëpërfshirëse, në përputhje me hapësirën fiskale të qeverisë.


Parimi 4: Politikat publike zhvillohen mbi bazën e dëshmimeve dhe analizës, duke ndjekur rregulla të qarta dhe të qëndrueshme për hartimin e legjislacionit; ligjet dhe rregulloret janë lehtësisht të qasshme.

Parimi 5: Të gjitha palët kryesore të jashtme dhe të brendshme të interesit, si dhe publiku i gjerë, konsultohen në mënyrë aktive gjatë zhvillimit të politikave.

Parimi 6: Politikat publike zbatohen dhe vlerësohen në mënyrë efektive, duke përmirësuar rezultatet e politikave dhe duke ulur kostot dhe barrët rregullatore.

Parimi 7: Parlamenti ushtron mbikëqyrje efektive mbi politikëbërjen e qeverisë dhe siguron koherencën e përgjithshme të politikave dhe legjislacionit.

Këto Parime vlerësohen nga perspektiva e disponueshmërisë, qasshmërisë dhe publikimit me kohë të të gjitha informacioneve relevante mbi planifikimin, raportimin dhe vendimmarrjen e qeverisë, duke shqyrtuar njëkohësisht gjithëpërfshirjen e zhvillimit të politikave dhe legjislacionit. Fokusi në transparencë dhe gjithëpërfshirje synon gjithashtu të përcaktojë nëse politikat monitorohen dhe vlerësohen rregullisht, si dhe nëse ato i nënshtrohen mbikëqyrjes parlamentare.



Periudha e monitorimit për fushën e Hartimit dhe Koordinimit të Politikave mbulon zhvillimet që nga cikli i fundit i Monitorimit të Reformës së Administratës Publike (RAP), i cili zgjati nga janari deri në nëntor të vitit 2022. Prandaj, ky raport fokusohet kryesisht në periudhën nga viti 2023 deri në vitin 2025, si dhe në zhvillimet e fundit të vitit 2022 që nuk janë përfshirë në ciklin paraprak.

Megjithëse ky raport ofron krahasim të gjetjeve me edicionet e mëparshme të Monitorimit të RAP-it, pikët e vendeve nuk janë të krahasueshme me monitorimin paraprak për shkak të ndryshimeve metodologjike.

Sub-indikatori i parë fokusohet në ekzistencën e dispozitave të kornizës strategjike dhe ligjore që mundësojnë vendimmarrje transparente të qeverisë, duke shqyrtuar gjithashtu nëse dokumentet kyçe janë të qasshme në praktikë, si: agjendat e mbledhjeve të qeverisë, procesverbalet, vendimet dhe komunikatat për media. Për vlerësimin e rezultateve dhe ndikimit, hulumtuesit zhvillojnë tri intervista me informatorë kyç nga akterë jo-shtetërorë, të cilët kanë ekspertizë të konsiderueshme në këtë fushë.

Tabela 2. Elementet e indikatorit në kuadër të subindikatorit 1

Element tregues - numër dhe titull	Lloji
E 1.1 Ekziston një dokument strategjik në fuqi që parasheh përmirësimin e transparencës së procesit të vendimmarrjes së qeverisë.	Strategjia dhe politikat
E 1.2 Rregulloret përcaktojnë transparencën e procesit të vendimmarrjes së qeverisë.	Legjislacioni
E 1.3 Qeveria publikon rregullisht online pikat e rendit të ditës, procesverbalet dhe komunikatat për media nga mbledhjet e saj.	Praktika në zbatim
E 1.4 Qeveria publikon rregullisht online vendimet nga mbledhjet e saj.	Praktika në zbatim
E 1.5 Aktorët kryesorë jo-shtetërorë e konsiderojnë transparent procesin e vendimmarrjes së Qeverisë.	Rezultatet dhe ndikimi

Sub-indikatori i dytë vlerëson afatin kohor, disponueshmërinë dhe rregullsinë e publikimit të dokumenteve të planifikimit të qeverisë dhe raporteve mbi zbatimin e tyre, duke shqyrtuar gjithashtu nëse janë të pranishëm indikatorët e bazuar në performancë dhe elementet e kuptueshme për qytetarët. Monitorimi i elementeve të strategjisë dhe politikave, legjislacionit dhe praktikës realizohet përmes analizimit të dokumenteve strategjike, akteve ligjore dhe të dhënave zyrtare të publikuara në faqet zyrtare të institucioneve relevante. Vlerësimi i rezultateve dhe ndikimit bazohet në gjetjet e marra nga tri intervista me informatorë kyç, njësoj si në sub-indikatorin paraprak.

Tabela 3. Elementet e indikatorit në kuadër të sub-indikatorit 2

Elementi i indikatorit: numri dhe titulli	Lloji
E 2.1 Ekziston një dokument strategjik në fuqi që parasheh përmirësimin e praktikës së planifikimit dhe raportimit të qeverisë.	Strategjia dhe politikat
E 2.2 Rregulloret përcaktojnë qasshmërinë publike të dokumenteve të planifikimit të qeverisë dhe raporteve mbi zbatimin e tyre.	Legjislacioni
E 2.3 Rregulloret përcaktojnë qasshmërinë publike të planeve të integritit evropian të qeverisë dhe raporteve mbi zbatimin e tyre.	Legjislacioni
E 2.4 Qeveria publikon rregullisht dhe me kohë planet e saj vjetore të punës.	Praktika në zbatim
E 2.5 Qeveria publikon programin e saj në kohë.	Praktika në zbatim
E 2.6 Programi dhe planet e punës së qeverisë përmbajnë indikatorë të performancës për monitorimin e arritjes së rezultateve.	Praktika në zbatim
E 2.7 Qeveria publikon rregullisht dhe me kohë raportet mbi zbatimin e planeve të saj të punës.	Praktika në zbatim
E 2.8 Qeveria publikon rregullisht dhe me kohë raportet mbi zbatimin e programit të saj.	Praktika në zbatim
E 2.9 Qeveria publikon rregullisht dhe me kohë planet e saj të integritit evropian.	Praktika në zbatim
E 2.10 Qeveria publikon rregullisht dhe me kohë raportet mbi zbatimin e planeve të saj të integritit evropian.	Praktika në zbatim
E 2.11 Raportet e qeverisë mbi zbatimin e programeve dhe planeve të saj të punës përfshijnë vlerësime mbi arritjen e rezultateve kryesore dhe indikatorëve të performancës.	Praktika në zbatim
E 2.12 Planet dhe raportet e qeverisë janë të kuptueshme dhe miqësore për qytetarët.	Praktika në zbatim
E 2.13 Të dhënat e përfshira në raportet e qeverisë mbi zbatimin e planeve të punës janë të disponueshme në format të hapur.	Praktika në zbatim
E 2.14 Aktorët kryesorë jo-shtetërorë i konsiderojnë aktivitetet e planifikimit dhe raportimit të Qeverisë si transparente, të publikuara me kohë dhe miqësore për qytetarët.	Rezultatet dhe ndikimi

Sub-indikatori i tretë synon të shqyrtojë nëse zhvillimi i politikave dhe legjislacionit është transparent, gjithëpërfshirës dhe i bazuar në dëshmi, si në kuadrin strategjik dhe ligjor, ashtu edhe në zbatimin e tij në praktikë. Kjo përfshin pjesëmarrjen kuptimplotë të palëve të interesit që nga fazat më të hershme, raportimin e rregullt dhe gjithëpërfshirës mbi konsultimet, zbatimin dhe raportimin mbi vlerësimet e ndikimit, mbikëqyrjen e kërkesave për konsultim, si dhe ndikimin e kontributit publik në vendimet përfundimtare.

Monitorimi i aspekteve të strategjisë dhe politikave, legjislationit, organizimit institucional dhe praktikës realizohet duke kombinuar burime të ndryshme të të dhënave për të maksimizuar besueshmërinë e rezultateve. Kjo përfshin analizën cilësore të dokumenteve strategjike, akteve ligjore dhe të dhënave zyrtare që janë të disponueshme publikisht ose që merren nga institucionet përgjegjëse përmes kërkesave për qasje në dokumente publike (FOI). Analiza e elementeve të tipit praktikë në kuadër të këtij sub-indikatori realizohet mbi një mostër të dokumenteve të politikave publike dhe akteve ligjore të miratuara gjatë periudhës 12-mujore që i paraprin periudhës së monitorimit. Disa elemente bazohen në një mostër prej dy dokumenteve të miratuara të politikave publike dhe tre ligjeve të miratuara, të cilat vlerësohen se kanë ndikim të rëndësishëm në shoqëri ose në grupe specifike të prekura. Për vlerësimin e rezultateve dhe ndikimit, hulumtuesit zhvillojnë tri intervista me informatorë kyç nga aktorë jo-shtetërorë, anëtarë të grupeve punuese për hartimin e dokumenteve mostër të politikave publike dhe ligjeve, si dhe përdorin gjetjet e anketës së WeBER-it mbi perceptimin publik.

Tabela 4. Elementet e indikatorit në kuadër të sub-indikatorit 3

Elementet e indikatorit: numri dhe titulli	Lloji
E 3.1 Ekziston një dokument strategjik në fuqi që parasheh përmirësimin e transparencës dhe gjithëpërfshirjes në procesin e politikëbërjes dhe zhvillimit të legjislationit.	Strategjia dhe Politika
E 3.2 Rregulloret parashohin transparencën dhe gjithëpërfshirjen e procesit të politikëbërjes dhe zhvillimit të legjislationit.	Legjislationi
E 3.3 Rregulloret përcaktojnë kërkesat minimale për konsultim.	Legjislationi
E 3.4 Rregulloret parashohin qasje online dhe pa pagesë në versionet e konsoliduara të të gjitha dokumenteve të politikave dhe legjislationit.	Legjislationi
E 3.5 Rregulloret përcaktojnë vlerësimin e detyrueshëm paraprak të ndikimit – përfshirë ndikimin në barazinë gjinore – gjatë politikëbërjes, si dhe publikimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit.	Legjislationi
E 3.6 Ekziston një institucion i caktuar qeveritar për të kontrolluar pajtueshmërinë me kërkesat për konsultim.	Organizimi institucional
E 3.7 Vlerësimet paraprake të ndikimit – përfshirë ndikimin në barazinë gjinore – zbatohen në mënyrë të qëndrueshme gjatë hartimit të dokumenteve të politikave.	Praktika në zbatim
E 3.8 Vlerësimet paraprake të ndikimit – përfshirë ndikimin në barazinë gjinore – zbatohen në mënyrë të qëndrueshme gjatë hartimit të legjislationit primar.	Praktika në zbatim
E 3.9 Raportet mbi vlerësimet paraprake të ndikimit të realizuara gjatë hartimit të legjislationit primar publikohen rregullisht online, së bashku me draft-dokumentet.	Praktika në zbatim

E 3.10 Raportet e publikuara mbi vlerësimet paraprake të ndikimit gjatë hartimit të legjislacionit primar përmbajnë informacionet kyçe.	Praktika në zbatim
E 3.11 Aktorët jo-shtetërorë marrin pjesë në grupet punuese të udhëhequra nga qeveria për hartimin e politikave dhe legjislacionit.	Praktika në zbatim
E 3.12 Procedurat dhe vendimet e grupeve punuese janë transparente.	Praktika në zbatim
E 3.13 Konsultimet publike për dokumentet e politikave dhe legjislacionin primar mbahen rregullisht.	Praktika në zbatim
E 3.14 Konsultimet publike zhvillohen në një fazë të hershme të hartimit të politikave.	Praktika në zbatim
E 3.15 Raportet mbi konsultimet publike për dokumentet e politikave janë të qasshme publikisht.	Praktika në zbatim
E 3.16 Raportet mbi konsultimet publike për legjislacionin primar janë të qasshme publikisht.	Praktika në zbatim
E 3.17 Raportet e konsultimeve publike përmbajnë të gjitha elementet e procesit të konsultimit të realizuar.	Praktika në zbatim
E 3.18 Portali qendror online për zhvillimin e konsultimeve përdoret rregullisht.	Praktika në zbatim
E 3.19 Institucioni i caktuar qeveritar kontrollon rregullisht pajtueshmërinë me kërkesat për konsultime publike.	Praktika në zbatim
E 3.20 Ministritë përgjegjëse informojnë në mënyrë proaktive për konsultimet publike.	Praktika në zbatim
E 3.21 Versionet e konsoliduara të legjislacionit primar dhe sekondar janë lehtësisht të qasshme online dhe të disponueshme pa pagesë.	Praktika në zbatim
E 3.22 Rezultatet e konsultimeve publike ndikojnë në propozimet përfundimtare të politikave dhe legjislacionit.	Rezultatet dhe ndikimi
E 3.23 Aktorët kryesorë jo-shtetërorë e konsiderojnë punën e grupeve punuese të udhëhequra nga qeveria si transparente dhe gjithëpërfshirëse.	Rezultatet dhe ndikimi
E 3.24 Perceptimi i qytetarëve për mundësinë e tyre për të marrë pjesë në hartimin e ligjeve dhe strategjive.	Rezultatet dhe ndikimi

Sub-indikatori i katërt fokusohet në transparencën e zbatimit të politikave përmes disponueshmërisë së raporteve të monitorimit dhe vlerësimeve ex-post, njoftimeve paraprake për grupet e prekura lidhur me ndryshimet e ardhshme në kuadrin ligjor, si dhe përfshirjes së aktorëve jo-shtetërorë në shqyrtimet parlamentare përmes dëgjimeve publike. Monitorimi i këtij sub-indikatori bazohet në shqyrtimin e kornizës strategjike, rregulloreve, si dhe faqeve të internetit dhe dokumenteve të institucioneve relevante. Për vlerësimin e rezultateve dhe ndikimit, hulumtuesit zhvillojnë tri intervista me informatorë kyç nga aktorë jo-shtetërorë, pjesëmarrës në dëgjimet publike të organizuara nga parlamenti.

Tabela 5. Elementet e indikatorit në kuadër të sub-indikatorit 4

Elementet e indikatorit: numri dhe titulli	Lloji
E 4.1 Ekziston një dokument strategjik në fuqi që parasheh transparencën dhe gjithëpërfshirjen e praktikave të monitorimit dhe vlerësimit të politikave.	Strategjia dhe politika
E 4.2 Rregulloret parashohin dërgimin e njoftimeve paraprake për grupet e prekura lidhur me ndryshimet e ardhshme në kuadrin ligjor.	Legjislacioni
E 4.3 Rregullorja e punës së parlamentit parasheh pjesëmarrjen e palëve të interesuara në diskutimet parlamentare, në formën e dëgjimeve publike.	Legjislacioni
E 4.4 Ministritë përgjegjëse publikojnë njoftime paraprake për grupet e prekura lidhur me ndryshimet e ardhshme në kuadrin ligjor.	Praktika në zbatim
E 4.5 Ministritë përgjegjëse publikojnë rregullisht raporte monitorimi mbi zbatimin e dokumenteve të politikave.	Praktika në zbatim
E 4.6 Raportet e monitorimit mbi zbatimin e politikave janë të kuptueshme dhe miqësore për qytetarët.	Praktika në zbatim
E 4.7 Ministritë përgjegjëse publikojnë vlerësime ex-post mbi zbatimin e politikave.	Praktika në zbatim
E 4.8 Vlerësimet paraprake mbi zbatimin e politikave përdorin të dhëna dhe informacione të jashtme të prodhuara nga aktorë jo-shtetërorë.	Praktika në zbatim
E 4.9 Parlamenti përfshin palët e interesit, grupet e prekura dhe aktorë të tjerë jo-shtetërorë në dëgjimet publike.	Praktika në zbatim
E 4.10 Transparenca online e punës së parlamentit.	Praktika në zbatim
E 4.11 Akterët kryesorë jo-shtetërorë e konsiderojnë efektive përfshirjen e palëve të interesit në dëgjimet publike.	Rezultati dhe ndikimi

II. Transparenca dhe Gjithëpërfshirja në Hartimin dhe Koordinimin e Politikave

Ky seksion paraqet rezultatet e vlerësimit për Kosovën. Secili nënseksion paraqet rezultatet për një sub-indikator (gjithsej katër), duke filluar me një përmbledhje të shkurtër të zhvillimeve që nga Monitorimi i Reformës së Administratës Publike (RAP) 2021/2022. Kjo pasohet nga një vlerësim i detajuar i elementeve të sub-indikatorit, duke filluar me kuadrin e politikave, legjislacionit dhe organizimit institucional, më pas duke kaluar te praktika e zbatimit, dhe duke përfunduar me rezultatet dhe ndikimin. Çdo vlerësim i sub-indikatorit përfundon me grafikun që paraqet pikët e fituara.

Grafiku më poshtë paraqet rezultatet e përgjithshme për fushën e Hartimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë, të matura në një shkallë nga 0 deri në 100 pikë.

Transparenca dhe gjithëpërfshirja në hartimin dhe koordinimin e politikave(pikët 0-100)



II.1 Transparenca dhe gjithëpërfshirja e procesit të vendimarrjes së qeverisë

Parimi 2: Politikat publike janë koherente dhe koordinohen në mënyrë efektive nga qendra e qeverisë; vendimet përgatiten dhe komunikohen në mënyrë të qartë dhe transparente.

Pikët e dhëna për secilin element në kuadër të sub-indikatorit 1: Gjithëpërfshirja dhe transparenca e procesit të vendimarrjes së qeverisë⁵

5 Sub-indikatorit i parë fokusohet në nënparimet e mëposhtme të SIGMA: Qendra e qeverisë (CoG) mundëson dhe lehtëson koordinimin e politikave ndërmjet ministrive dhe institucioneve relevante për të siguruar koherencë të përgjithshme të politikave dhe rezultate më të mira dhe më të qëndrueshme të tyre; Vendimet e qeverisë përgatiten, miratohen dhe ndiqen në mënyrë transparente, efektive dhe me kohë, bazuar në rregulla dhe procedura të qarta, përmes strukturave relevante të vendimarrjes, përfshirë mbledhjet e qeverisë.

Elementet e indikatorit	Lloji i elementit	Pikët
E 1.1 Ekziston një dokument strategjik në fuqi që parasheh përmirësimin e transparencës së procesit të vendimmarrjes së qeverisë.	Strategjia dhe politika	0/0.5
E 1.2 Rregulloret përcaktojnë transparencën e procesit të vendimmarrjes së qeverisë.	Legjislacioni	0.25/1
E 1.3 Qeveria publikon rregullisht online pikat e rendit të ditës, procesverbalet dhe komunikatat për media nga mbledhjet e saj.	Praktika në zbatim	0.5/2
E 1.4 Qeveria publikon rregullisht online vendimet nga mbledhjet e saj.	Praktika në zbatim	2.5/2.5
E 1.5 Aktorët kryesorë jo-shtetërorë e konsiderojnë transparent procesin e vendimmarrjes së Qeverisë.	Rezultati dhe ndikimi	0.75/3
Pikët totale të sub-indikatorit 1		4/9

Gjendja aktuale

Ky sub-indikator vlerëson procesin e vendimmarrjes së qeverisë në aspektin e gjithëpërfshirjes dhe transparencës. Strategjia për Reformën e Administratës Publike (RAP) nuk parasheh ndonjë përmirësim në këtë drejtim. Rregullorja e Punës së Qeverisë kërkon transparencë në punën e Qeverisë përmes publikimit të vendimeve që dalin nga mbledhjet e qeverisë. Megjithatë, publikimi i agjendave të mbledhjeve të Qeverisë, procesverbaleve apo komunikatave për media nuk kërkohet. Në praktikë, nga 13 mbledhje të qeverisë, janë publikuar 11 komunikata për media, 2 agjenda dhe asnjë procesverbal. Në të kundërtën, në përputhje me kërkesat ligjore, 100% e vendimeve janë publikuar brenda një jave nga mbajtja e mbledhjes. Nga Gjithsej 9 pikë të mundshme, ky sub-indikator është vlerësuar me 4 pikë.

Korniza strategjike e Reformës së Administratës Publike (RAP) nuk ofron dispozita të qarta që parashohin përmirësime të transparencës së procesit të vendimmarrjes ndaj publikut. Për më tepër, kërkesat ligjore për transparencë janë vlerësuar në lidhje me mbledhjet e Qeverisë, duke shqyrtuar disponueshmërinë publike të agjendave, procesverbaleve, vendimeve që dalin nga mbledhjet, si dhe publikimin e një komunikate për media për secilën mbledhje të mbajtur. Nga këto elemente, Qeveria e Kosovës përmes Rregullores së Punës së Qeverisë (RoP) rregullon në mënyrë eksplicite vetëm publikimin e vendimeve. Neni 85 i Rregullores së Punës, në kuadër të nënkapitullit mbi Parimet e Përgjithshme për publicitetin e punës së Qeverisë, e obligon Qeverinë që të informojë publikun për punën dhe vendimet e saj.


Agjendat, komunikatat për media dhe procesverbalet e mbledhjeve të qeverisë nuk kërkohet domosdoshmërisht të publikohen. Si rezultat, qeveria ka ndjekur një qasje të ngushtë, duke publikuar vetëm informacionin që kërkohet në mënyrë strikte me ligj. Gjatë periudhës tre mujore të monitorimit, Qeveria në detyrë e Kosovës mbajti 13 mbledhje. Sa i përket publikimit të dokumenteve, 2

agjenda të këtyre mbledhjeve u publikuan para mbledhjes, ndërsa të tjerat nuk u publikuan (15%); asnjë nga procesverbalet nuk u publikuan; 11 komunikata për media u bënë publike pas mbledhjeve (85%). Të paktën 80% e secilit prej këtyre dokumenteve duhet të publikohen në mënyrë që të vlerësohen pozitivisht. Nga ana tjetër, 100% e vendimeve u publikuan. Në 13 mbledhje të qeverisë u morën 58 vendime dhe të gjitha u bënë publike përmes Gazetës Zyrtare, brenda një jave nga mbajtja e mbledhjes.

Intervistat me informatorët kyç nxorën në pah të njëjtin përfundim për disa çështje.⁶ Ata nuk pajtohen kolektivisht se pikat e rendit të ditës dhe procesverbalet e mbledhjeve të qeverisë janë transparente, apo madje se qeveria informon publikisht për procesin e saj të vendimmarrjes përmes komunikatave për media. Megjithatë, siç përfundon raporti, të intervistuarit ndajnë pikëpamjen e përbashkët se vendimet e qeverisë janë transparente.

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?

Sub-indikatori 1: Transparenca dhe gjithëpërfshirja e procesit të vendimmarrjes së qeverisë (maksimumi i pikëve: 9)



II.2 Transparenca e planifikimit dhe raportimit të qeverisë

Parimi 3: Qeveria planifikon dhe monitoron politikat publike në mënyrë efektive dhe gjithëpërfshirëse, në përputhje me hapësirën fiskale të qeverisë.

Pikët e dhëna për secilin element në kuadër të sub-indikatorit 2: Transparenca e planifikimit dhe raportimit të qeverisë⁷

⁶ Intervistat u zhvilluan me tre informatorë kyç, aktorë jo-shtetërorë nga shoqëria civile me përvojë në këtë fushë. Intervistat u mbajtën më 11 dhjetor 2025 dhe më 5 mars 2026.

⁷ Sub-indikatori i dytë fokusohet në nënparimet e mëposhtme të SIGMA: Dokumentet e planifikimit të politikave përmbushin kërkesat cilësore dhe përmbajnë analiza dhe informacione të mjaftueshme, përfshirë objektivat e politikave, indikatorët me synime të përcaktuara dhe kornizën e monitorimit. Ato hartohen në mënyrë pjesëmarrëse dhe janë publikisht të qasshme; Performanca dhe rezultatet, përfshirë arritjen e objektivave të politikave dhe indikatorëve të rezultateve, monitorohen dhe raportohen rregullisht; raportet e monitorimit publikohen me kohë

Elementet e Indikatorit	Tipi i Elementit	Pikët
E 2.1 Ekziston një dokument strategjik në fuqi që parasheh përmirësimin e praktikës së planifikimit dhe raportimit të qeverisë.	Strategjia dhe politika	0/0.5
E 2.2 Rregulloret përcaktojnë qasshmërinë publike të dokumenteve të planifikimit të qeverisë dhe raporteve mbi zbatimin e tyre.	Legjislacioni	0.25/0.5
E 2.3 Rregulloret përcaktojnë qasshmërinë publike të planeve të integritimit evropian të qeverisë dhe raporteve mbi zbatimin e tyre.	Legjislacioni	0/0.5
E 2.4 Qeveria publikon rregullisht dhe me kohë planet e saj vjetore të punës.	Praktika në zbatim	1.5/1.5
E 2.5 Qeveria publikon programin e saj në kohë.	Praktika në zbatim	0/1.5
E 2.6 Programet dhe planet e punës së qeverisë përmbajnë indikatorë të performancës për monitorimin e arritjes së rezultateve.	Praktika në zbatim	0.75/1.5
E 2.7 Qeveria publikon rregullisht dhe me kohë raportet mbi zbatimin e planeve të saj të punës.	Praktika në zbatim	0/1.5
E 2.8 Qeveria publikon rregullisht dhe me kohë raportet mbi zbatimin e programit të saj.	Praktika në zbatim	0/1.5
E 2.9 Qeveria publikon rregullisht dhe me kohë planet e saj të integritimit evropian.	Praktika në zbatim	0/1.5
E 2.10 Qeveria publikon rregullisht dhe me kohë raportet mbi zbatimin e planeve të saj të integritimit evropian.	Praktika në zbatim	0/1.5
E 2.11 Raportet e qeverisë mbi zbatimin e programeve dhe planeve të saj të punës përfshijnë vlerësime mbi arritjen e rezultateve kryesore dhe indikatorëve të performancës.	Praktika në zbatim	0/2
E 2.12 Planet dhe raportet e qeverisë janë të kuptueshme dhe miqësore për qytetarët.	Praktika në zbatim	1/1.5
E 2.13 Të dhënat e përfshira në raportet e qeverisë mbi zbatimin e planeve të punës janë të disponueshme në format të hapur.	Praktika në zbatim	0/1.5
E 2.14 Aktorët kryesorë jo-shtetërorë i konsiderojnë aktivitetet e planifikimit dhe raportimit të Qeverisë si transparente, të publikuara me kohë dhe miqësore për qytetarët.	Rezultati dhe ndikimi	0/3
Pikët totale të sub-indikatorit 2		3.5/20

për të mundësuar shqyrtim publik; Qeveria zbaton në mënyrë efektive planet e integritimit evropian (EI) përmes prioritizimit dhe kostimit të obligimeve që lidhen me integritimin evropian, duke marrë parasysh burimet dhe kapacitetet e disponueshme të administratës.

Gjendja aktuale

Sub-indikatori 2 shqyrton transparencën dhe gjithëpërfshirjen në planifikimin dhe raportimin e qeverisë. Ai vlerëson nëse ekzistojnë rregulla strategjike dhe ligjore për publikimin e dokumenteve, si dhe sa mirë zbatohen këto rregulla në praktikë. Ky indikator fokusohet në atë nëse planet e punës, programet qeveritare dhe raportet e zbatimit janë të disponueshme dhe publikohen me kohë, si dhe në cilësinë e tyre, veçanërisht nëse përmbajnë indikatorë të performancës dhe vlerësime të rezultateve. Gjithashtu, ai shqyrton nëse këto dokumente janë të lehta për t'u qasur dhe kuptuar nga qytetarët, si dhe nëse të dhënat publikohen në formate të hapura. Një pjesë e rëndësishme e këtij indikator është edhe mënyra se si aktorët jo-shtetërorë e perceptojnë transparencën dhe gjithëpërfshirjen e këtyre proceseve. Në rastin e Kosovës, këtij sub-indikator i janë dhënë 3.50 pikë nga gjithsej 20 pikë të mundshme.

Në Strategjinë për Reformën e Administratës Publike 2022–2027,⁸ metodologjia kërkon që të ketë masa të qarta dhe konkrete për përmirësimin e praktikave të planifikimit të qeverisë dhe përmirësimin e praktikave të raportimit të qeverisë, me përcaktim të qartë të përgjegjësi. Megjithatë, gjetjet e monitorimit tregojnë se, ndonëse ekzistojnë disa elemente të ndërlidhura, nuk ka masa konkrete apo të mjaftueshme që adresojnë drejtpërdrejt këto dy fusha në mënyrë të qartë dhe të strukturuar, siç kërkohet nga metodologjia.

Për shembull, në pjesën e strategjisë që trajton planifikimin dhe koordinimin e politikave, ekziston një masë e përgjithshme e lidhur me planifikimin dhe koordinimin e politikave, si dhe objektiva të përgjithshme si përmirësimi i kornizës së menaxhimit strategjik, përmirësimi i performancës institucionale, transparencës dhe llogaridhënies, si dhe forcimi i vlerësimit të ndikimit rregullator dhe lidhja më e mirë me *acquis* të Bashkimit Evropian. Megjithatë, këto mbeten objektiva të përgjithshme dhe nuk përfshijnë masa të qarta dhe specifike që përmirësojnë drejtpërdrejt praktikën e planifikimit dhe raportimit të qeverisë.

Në pjesën e strategjisë kushtuar monitorimit,⁹ thuhet se një njësi përgjegjëse në administratë do të përgatisë një raport monitorimi dy herë në vit. Ky raport përfshin një përmbledhje të progresit, rekomandime për përmirësime, një përmbledhje të aktiviteteve dhe veprimet e planifikuara për periudhën e ardhshme. Raporti gjithashtu shqyrtohet nga strukturat koordinuese dhe diskutohet në nivel të Këshillit për Reformën e Administratës Publike. Megjithatë, këto dispozita ende nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e metodologjisë, sepse ato nuk përcaktojnë qartë masa të forta dhe specifike për përmirësimin e sistemeve të planifikimit dhe raportimit në mënyrë të plotë. Për këtë arsye, kjo pjesë vlerësohet negativisht për shkak të mungesës së masave konkrete ose të mjaftueshme.

8 *Strategjia për përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave (SPPKP) 2022–2027* <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/4909/STRATEGJIA-E-REFORMES-SE-ADMINISTRATES-PUBLIKE-2022-2027.pdf>.

9 Ibid., 60.

Nga ana pozitive, korniza ligjore¹⁰ përcakton qartë se Programi i Qeverisë miratohet si dokumenti kryesor politik i Qeverisë dhe publikohet në faqen zyrtare të Zyrës së Kryeministrit. Gjithashtu, rregullorja e Qeverisë përcakton se Plani Vjetor i Punës së Qeverisë publikohet në faqen zyrtare të Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrive.

Megjithatë, e njëjta kornizë nuk kërkon qartë publikimin e raporteve mbi zbatimin e Programit të Qeverisë si një obligim të veçantë dhe të qartë. Edhe pse ekziston kërkesa për përgatitjen e një raporti vjetor të qeverisë që përfshin informacione të detajuara mbi progresin e zbatimit, përfshirë rezultatet kundrejt objektivave, afatin kohor të veprimeve, përdorimin e burimeve financiare, sfidat kryesore, faktorët e rinj që ndikojnë në zbatim dhe masat korrigjuese, nuk ekziston një rregull i qartë dhe i fortë që garanton se raportet mbi zbatimin e dokumenteve planifikuese publikohen gjithmonë në mënyrë të qëndrueshme dhe të detyrueshme si pjesë e obligimeve zyrtare për transparencë.¹¹ Nga ana negative, korniza kombëtare për integrimin evropian nuk përfshin një dispozitë të qartë ligjore që e obligon Qeverinë të publikojë në mënyrë proaktive “Programin Kombëtar për Integrim Evropian 2024–2028” në faqen e saj zyrtare brenda një afati të përcaktuar. Si rezultat, publikimi nuk është i rregulluar plotësisht me ligj dhe mbështetet në praktikën e krijuar.

Nga perspektiva praktike, gjetjet e monitorimit tregojnë se Programi i Qeverisë 2021–2025 ekziston si dokument zyrtar dhe është i qashtë për publikun në formë elektronike përmes burimeve institucionale. Megjithatë, ai nuk është publikuar në faqen zyrtare të Qeverisë. Në vend të kësaj, dokumenti është gjetur në faqen e një ministrie¹² tjetër në format PDF. Për këtë arsye, ky element vlerësohet negativisht, sepse kërkesa është që dokumenti të publikohet drejtpërdrejt në faqen zyrtare të Qeverisë për të siguruar një pikë të vetme, të qartë dhe transparente të qasjes për publikun.

Gjithashtu, Plani i Punës së Qeverisë është publikuar ndër vite në faza të ndryshme, por me ndryshime në format dhe emërtim gjatë viteve. Dokumenti i njohur si “Plani Vjetor i Punës së Qeverisë” është publikuar për herë të fundit në vitin 2019, duke treguar një ndërprerje të këtij formati të mëhershëm të planifikimit dhe raportimit. Pas kësaj, një dokument i ngjashëm është publikuar me një emër tjetër, “Plani Kombëtar për Zhvillim (PKZH) 2024–2026”,¹³ i cili është publikuar më 25 janar 2024 dhe është i disponueshëm në faqen zyrtare

¹⁰ Ligji Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=66686>.

¹¹ Lidhur me publikimin e raporteve, Neni 7 i Rregullores së Punës së Qeverisë 17/2024 përcakton se para datës 1 mars të çdo viti, Qeveria miraton dhe autorizon publikimin e raportit të saj vjetor. Meqenëse indikator i metodologjisë kërkon që korniza ligjore të përcaktojë gjithashtu publikimin e raporteve mbi zbatimin e Programit të Qeverisë, vlerësimi rezultoi me pikë negative.

¹² Ky dokument është gjetur në faqen zyrtare të Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në format PDF. Shih më poshtë: <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/06/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>.

¹³ Plani Kombëtar për Zhvillim (PKZH) 2024–2026 <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/01/PKZH-2024-2026.pdf>

të Qeverisë. Ky dokument është publikuar me kohë dhe është i qasshëm përmes platformës zyrtare të Qeverisë, duke treguar vazhdimësi në planifikimin qeveritar, por me një strukturë dhe qasje të re.

Megjithatë, ndryshimi i emrit dhe formatit, si dhe mungesa e vazhdimësisë së qartë të të njëjtit dokument brenda një kornize të vetme dhe të qëndrueshme, tregon një evolucion në praktikën e planifikimit, por edhe një ndërprerje të konsistencës në mënyrën se si këto dokumente publikohen ndër vite. Ajo që mungon në praktikë është publikimi i raporteve mbi zbatimin e planeve të punës. Këto raporte nuk bëhen publike. Për këtë arsye, ky element vlerësohet negativisht.

Bazuar në gjetjet, dokumentet kryesore të planifikimit dhe monitorimit paraqesin përgjithësisht një format miqësor për përdoruesit. Plani i Punës së Qeverisë, i paraqitur tani nën emrin “Plani Kombëtar për Zhvillim (PKZH) 2024–2026”, është i strukturuar në mënyrë të qartë, me seksione të organizuara mirë, përmbledhje dhe elemente vizuale si kategorizimi dhe përdorimi i ngjyrave. Kjo e bën dokumentin më të lehtë për t’u lexuar dhe i ndihmon përdoruesit të kuptojnë shpejt prioritetet kryesore të qeverisë në sektorë të ndryshëm.

Një nivel i ngjashëm qartësie mund të vërehet edhe në Planin për Integrim Evropian 2024–2028, i cili gjithashtu paraqitet në mënyrë të strukturuar dhe të qasshme. Ai përfshin përmbledhje dhe tabela të qarta që ndajnë informacionin në pjesë të kuptueshme, duke e bërë më të lehtë për lexuesit të ndjekin objektivat dhe veprimet kryesore. Raporti mbi zbatimin e Programit për Integrim Evropian për periudhën janar–shtator 2024¹⁴ është gjithashtu i dizajnuar në një mënyrë miqësore për përdoruesit. Ai përdor përmbledhje të qarta dhe mjete të prezantimit vizual, të cilat ndihmojnë në thjeshtimin e informacionit kompleks dhe e bëjnë atë më të qasshëm për përdoruesit.


Në përgjithësi, gjetjet tregojnë se, megjithëse struktura dhe formati i këtyre dokumenteve janë përgjithësisht të qasshme dhe të lehta për përdorim, ato mbështeten në masë të madhe në prezantimin vizual dhe përmbajtjen e përmbledhur për të përmirësuar lexueshmërinë. Për këtë indikator, janë zhvilluar gjithashtu intervista me tre përfaqësues të shoqërisë civile, dhe gjetjet tregojnë se të njëjtët akterë nuk janë pajtuar që aktivitetet e planifikimit dhe raportimit të qeverisë janë transparente apo se ato realizohen me kohë.¹⁵

14 Raporti mbi zbatimin e Programit për Integrim Evropian për periudhën Janar–Shtator 2024 <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/01/Raport-mbi-zbatimin-e-PKIE-janar-shtator-2024.pdf>.

15 Këto intervista janë zhvilluar në dhjetor 2025 dhe mars 2026.

Si qëndron Kosova në aspektin Rajonal ?

Sub-indikatori 2: Transparenca e planifikimit dhe raportimit të qeverisë (maksimumi i pikëve: 20)



II.3 Transparenca dhe gjithëpërfshirja e procesit të politikëbërjes dhe zhvillimit të legjislacionit

Parimi 4: Politikat publike zhvillohen mbi bazën e dëshmive dhe analizës, duke ndjekur rregulla të qarta dhe të qëndrueshme për hartimin e legjislacionit; ligjet dhe rregulloret janë lehtësisht të qasshme.

Parimi 5: Të gjitha palët kryesore të jashtme dhe të brendshme të interesit, si dhe publiku i gjerë, konsultohen në mënyrë aktive gjatë zhvillimit të politikave.

*Pikët e dhëna për secilin element në kuadër të sub-indikatorit 3: Transparenca dhe gjithëpërfshirja e procesit të politikëbërjes dhe zhvillimit të legjislacionit*¹⁶

¹⁶ Sub-indikatori i tretë fokusohet në nënparimet e mëposhtme të SIGMA: Ekziston dhe zbatohet në praktikë një politikë gjithëqeveritare për promovimin e rregullimit më të mirë, politikëbërjes së bazuar në dëshmi dhe politikëbërjes gjithëpërfshirëse gjatë zhvillimit të politikave dhe hartimit të legjislacionit; Ekzistojnë procedura që zbatohen dhe monitorohen në mënyrë të qëndrueshme për të mundësuar konsultime publike proaktive dhe efektive me palët e interesit dhe publikun e gjerë, duke u mundësuar bizneseve, organizatave joqeveritare dhe qytetarëve, përfshirë grupet e cenueshme, të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në politikëbërjen qeveritare; I gjithë legjislacioni primar dhe sekondar, përfshirë versionet e konsoliduara, është lehtësisht i qasshëm dhe i disponueshëm pa pagesë përmes databazave qendrore online. Dokumentet udhëzuese administrative, formularët dhe materialet thelbësore për respektimin e rregulloreve janë lehtësisht të disponueshme për bizneset dhe qytetarët; Vlerësimi i ndikimit rregullator (RIA), ose mjete të tjera të ngjashme, miratohet dhe përdoret në mënyrë sistematike për të mbështetur zhvillimin e politikave, për të lehtësuar konsultimet dhe për të informuar vendimarrjen në të gjitha fazat kryesore të politikëbërjes, duke mbuluar si legjislacionin primar ashtu edhe atë sekondar, përfshirë ndikimin në mjedis dhe klimë kur është e nevojshme; Konsultimi me publikun e gjerë zhvillohet në mënyrë të qasshme dhe transparente; Ministritë zhvillojnë dialog konstruktiv me palët kryesore të jashtme të interesit dhe mbledhin, analizojnë dhe përdorin të gjitha përgjigjet gjatë finalizimit të propozimeve të politikave. Ato raportojnë në mënyrë transparente mbi rezultatet e procesit të konsultimit publik dhe mënyrën se si pikëpamjet e të konsultuarve kanë ndikuar në politikë; Të gjitha ndikimet e mundshme të propozimeve të politikave analizohen në mënyrë sistematike; bëhen përpjekje të arsyeshme për të kuantifikuar dhe monetizuar ndikimet kryesore, përfshirë kostot shtesë për buxhetin e shtetit, bizneset dhe qytetarët; Ministritë kanë rregulla dhe procedura të qarta të brendshme për planifikimin dhe menaxhimin efektiv të zhvillimit të politikave dhe hartimit të legjislacionit.

Elementet e Indikatorit	Lloji i elementit	Pikët
E 3.1 Ekziston një dokument strategjik në fuqi që parasheh përmirësimin e transparencës dhe gjithëpërfshirjes në procesin e politikëbërjes dhe zhvillimit të legjislacionit.	Strategjia dhe Politikat	0.25/0.5
E 3.2 Rregulloret parashohin transparencën dhe gjithëpërfshirjen e procesit të politikëbërjes dhe zhvillimit të legjislacionit.	Legjislacioni	1.5/3
E 3.3 Rregulloret përcaktojnë kërkesat minimale për konsultim.	Legjislacioni	3.75/3.75
E 3.4 Rregulloret parashohin qasje online dhe pa pagesë në versionet e konsoliduara të të gjitha dokumenteve të politikave dhe legjislacionit.	Legjislacioni	1/1.5
E 3.5 Rregulloret përcaktojnë vlerësimin e detyrueshëm paraprak të ndikimit – përfshirë ndikimin në barazinë gjinore – gjatë politikëbërjes, si dhe publikimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit.	Legjislacioni	1.75/1.75
E 3.6 Ekziston një institucion i caktuar qeveritar për të kontrolluar pajtueshmërinë me kërkesat për konsultim.	Organizimi institucional	0/0.75
E 3.7 Vlerësimet paraprake të ndikimit – përfshirë ndikimin në barazinë gjinore – zbatohen në mënyrë të qëndrueshme gjatë hartimit të dokumenteve të politikave.	Praktika në zbatim	0.75/1.5
E 3.8 Vlerësimet paraprake të ndikimit – përfshirë ndikimin në barazinë gjinore – zbatohen në mënyrë të qëndrueshme gjatë hartimit të legjislacionit primar.	Praktika në zbatim	0/2
E 3.9 Raportet mbi vlerësimet paraprake të ndikimit të realizuara gjatë hartimit të legjislacionit primar publikohen rregullisht online, së bashku me draft-dokumentet.	Praktika në zbatim	0/1.5
E 3.10 Raportet e publikuara mbi vlerësimet paraprake të ndikimit gjatë hartimit të legjislacionit primar përmbajnë informacionet kyçe.	Praktika në zbatim	0/2.5
E 3.11 Akterët jo-shtetërorë marrin pjesë në grupet punuese të udhëhequra nga qeveria për hartimin e politikave dhe legjislacionit.	Praktika në zbatim	0/2
E 3.12 Procedurat dhe vendimet e grupeve punuese janë transparente.	Praktika në zbatim	1/2.5
E 3.13 Konsultimet publike për dokumentet e politikave dhe legjislacionin primar mbahen rregullisht.	Praktika në zbatim	0/2
E 3.14 Konsultimet publike zhvillohen në një fazë të hershme të hartimit të politikave.	Praktika në zbatim	0/1.5

E 3.15 Raportet mbi konsultimet publike për dokumentet e politikave janë të qasshme publikisht.	Praktika në zbatim	0/1.5
E 3.16 Raportet mbi konsultimet publike për legjislationin primar janë të qasshme publikisht.	Praktika në zbatim	0/1.5
E 3.17 Raportet e konsultimeve publike përmbajnë të gjitha elementet e procesit të konsultimit të realizuar.	Praktika në zbatim	1.5/3.75
E 3.18 Portali qendror online për zhvillimin e konsultimeve përdoret rregullisht.	Praktika në zbatim	0.75/2.25
E 3.19 Institucioni i caktuar qeveritar kontrollon rregullisht pajtueshmërinë me kërkesat për konsultime publike.	Praktika në zbatim	0/1.5
E 3.20 Ministritë përgjegjëse informojnë në mënyrë proaktive për konsultimet publike.	Praktika në zbatim	0/2.5
E 3.21 Versionet e konsoliduara të legjislationit primar dhe sekondar janë lehtësisht të qasshme online dhe të disponueshme pa pagesë.	Praktika në zbatim	1.5/1.5
E 3.22 Rezultatet e konsultimeve publike ndikojnë në propozimet përfundimtare të politikave dhe legjislationit.	Impakti dhe rezultati	1.5/3.75
E 3.23 Akterët kryesorë jo-shtetërorë e konsiderojnë punën e grupeve punuese të udhëhequra nga qeveria si transparente dhe gjithëpërfshirëse.	Impakti dhe rezultati	0/3
E 3.24 Perceptimi i qytetarëve për mundësinë e tyre për të marrë pjesë në hartimin e ligjeve dhe strategjive.	Impakti dhe rezultati	1/4
Pikët totale të sub-indikatorit 3		16.5/52

Gjendja aktuale

Korniza strategjike parasheh përmirësime në transparencën e procesit të politikëbërjes dhe legjislationit. Rregullorja e Punës së Qeverisë kërkon që për të gjitha draft-politikat dhe draft-legjislationin të kryhet një vlerësim paraprak i ndikimit. Ky vlerësim duhet të përfshijë edhe perspektivën gjinore. Kjo realizohet përmes një dokumenti koncept, i cili është hartuar pothuajse në të gjitha rastet (pesë nga gjashtë), por vetëm në tre prej tyre është kryer edhe vlerësimi i ndikimit gjinor. Rregulloret legjislative kërkojnë gjithashtu konsultime publike për dokumentet e politikave dhe legjislationin, por jo konsultime të hershme. Kjo reflektohet edhe në praktikë, ku për të gjitha dokumentet e politikave të vëzhguara gjatë periudhës së monitorimit janë mbajtur konsultime publike. Një raport përfundimtar mbi procesin e konsultimit zakonisht publikohet, me të gjitha komentet të paraqitura individualisht dhe me arsyetimin për pranimin ose refuzimin e secilit koment. Ky sub-indikator vlerëson gjithashtu transparencën dhe gjithëpërfshirjen e legjislationit, por meqenëse gjatë periudhës së monitorimit nuk është miratuar asnjë ligj, kjo pjesë është vlerësuar negativisht. Nga gjithsej 52 pikë të mundshme, këtij sub-indikator i janë ndarë vetëm 16.50 pikë.

Në kontrast me sub--indikatorët e tjerë, korniza strategjike e RAP-it parasheh njëfarë progresi në përmirësimin e transparencës, por jo edhe të gjithëpërfshirjes, në proceset e politikëbërjes dhe legjislativë. Plani i Veprimit i Strategjisë së RAP-it përmban 6 veprime që janë më specifiku të orientuara drejt transparencës, si përgatitja e indeksit apo pasaportës së indikatorëve, hartimi dhe trajnimi për manualin e ri mbi konsultimet publike, si dhe avancimi i platformës së konsultimeve publike.¹⁷

Rregullorja e Punës së Qeverisë rregullon konsultimet publike për projektpropozimet e dokumenteve të politikave, si dhe për legjislacionin primar dhe sekondar.¹⁸ Në anën tjetër, konsultimet e hershme me palët e interesit dhe grupet e synuara nuk kërkohen me rregullore. Përfshirja e akterëve jo-shtetërorë në punën e grupeve punuese gjithashtu është e rregulluar,¹⁹ por vetë puna e grupit punues nuk është e rregulluar sa i përket transparencës ndaj publikut.

Elementet e konsultimeve publike rregullohen gjithashtu me Rregulloren e Punës. Kohëzgjatja minimale e konsultimeve me shkrim është 15 ditë dhe mund të zgjatet deri në 30 ditë nëse akti është tepër kompleks.²⁰ Organi propozues duhet të njoftojë publikun dhe palët e interesuara të paktën 7 ditë para mbajtjes së takimit.²¹ Gjithashtu, rregullohen edhe dokumentet shoqëruese, formatet e konsultimeve publike dhe raportimi mbi konsultimet e realizuara. Qasja e lirë dhe publike në versionet e konsoliduara kërkohet me Rregulloren e Punës së Qeverisë për të gjitha dokumentet e politikave dhe legjislacionin primar, por jo edhe për legjislacionin sekondar.²² Zbatimi i vlerësimeve paraprake është i detyrueshëm gjatë zhvillimit dhe hartimit të të tri llojeve të dokumenteve. Sipas Rregullosës së Punës së Qeverisë, një koncept dokument duhet të hartohet para çdo ligji dhe dokumenti politikash,²³ ndërsa Manuali për koncept dokumentin e zgjeron këtë kërkesë edhe për aktet nënligjore.²⁴ Në këto koncept dokumente kërkohet të përfshijnë perspektivën gjinore në vlerësimet e tyre dhe publikimi i tyre është i detyrueshëm.²⁵ Megjithatë, përgjegjësia për verifikimin e përputhshmërisë²⁶ së procesit të konsultimeve të jashtme nuk është e rregulluar, që do të thotë se asnjë institucion nuk është formalisht i mandatu për ta kryer këtë funksion.

Sa i përket vlerësimeve paraprake, gjatë periudhës nga dhjetori 2024 deri në nëntor 2025, janë miratuar 6 dokumente politikash, prej të cilave 5 kanë kaluar

17 Shiko më konkretisht veprimet 1 dhe 9 deri në 13 në Planin e Veprimit 2025–2027 të Strategjisë për Reformën e Administratës Publike 2022–2027.

18 Rregullorja (GRK) – Nr. 17/2024 në Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, nenet 45 dhe 46.

19 Neni 18 paragrafi 4 dhe 5, Neni 31 paragrafi 4.

20 Neni 51 nënparagrafi 2.1 dhe 2.2.

21 Neni 50.

22 Neni 94 paragrafi 2 për dokumentet politike dhe Neni 92 për aktet juridike.

23 Neni 33 dhe 42.

24 Manuali për Hartimin e koncept dokumenteve, faqe 212. I disponueshëm në: https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Udhezuesi-dhe-Doracaku-per-Hartimin-e-Koncept-Dokumente-Shq-24-05-18_Publish.pdf

25 Rregullorja e Punës së Qeverisë, Neni 94 paragrafi 2.

26 Faqe 67 dhe 98.

nëpër një vlerësim paraprak, që përbën 83% të totalit. Megjithatë, vetëm 3 nga këto vlerësime kanë përfshirë edhe një vlerësim të ndikimit gjinor.²⁷ Gjatë periudhës së monitorimit, në Kuvend nuk është miratuar asnjë ligj, pasi Qeveria dhe Kuvendi kishin përfunduar mandatet e tyre në shkurt 2025 dhe vendi nuk kishte arritur të formonte institucione të reja deri në janar 2026. Për këtë arsye, nuk janë shqyrtuar vlerësime të ndikimit për ligjet, duke rezultuar me 0 pikë.

Duke vazhduar më tej, raporti vazhdon të vlerësojë elementet e dokumenteve të politikave dhe jo të ligjeve. Nga një mostër prej dy dokumenteve të politikave, Programi për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2025-2028 (ABPRP) dhe Programi i Pronësisë Industriale 2024-2026 (IPP), rezulton se IPP 2024-2026 nuk ka përfshirë asnjë aktor jo-shtetëror në grupin e tij punues, ndërsa ABPRP 2025-2028 kishte 6 OJQ në fazën fillestare të grupit punues. Asnjëri nga këto dy dokumente nuk ka publikuar përfundimet apo vendimet, procesverbalet e takimeve apo ndonjë lloj raporti mbi zhvillimet në mbledhjet e grupit punues. Ndërsa konsultimet e rregullta publike janë mbajtur për të gjashta dokumentet e politikave, konsultimet e hershme janë zhvilluar vetëm për dy prej tyre. Disa OJQ morën pjesë në takimet për ABPRP 2025-2028, ndërsa Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2025-2030 përfshiu vetëm institucionet përkatëse.

Për të gjitha proceset e konsultimeve publike, përveç njërit, është publikuar një raport përfundimtar dhe të gjitha komentet e dhëna nga shoqëria civile apo qytetarët janë përfshirë në raport. Në mostrën prej dy dokumenteve të politikave të shqyrtuara për qëllimet e këtij raporti, ABPRP 2025-2028 dhe IPP 2024-2026, të gjitha komentet nga procesi i konsultimit janë paraqitur individualisht në raport, jo në mënyrë të agreguar, duke ofruar reagim të qartë për secilin propozim individual si dhe arsyetim për refuzimin ose miratimin e secilit propozim. Duke analizuar komentet individualisht nga raporti përfundimtar, nga 57 komentet e paraqitura për ABPRP 2025-2028, 53 janë pranuar dhe integruar. Ndërsa për IPP 2024-2026, të gjitha 3 komentet e paraqitura janë pranuar. Përqindja e komenteve të pranuar për ABPRP është 93%, ndërsa për IPP është 100%.

Sa i përket përdorimit të portalit të e-konsultimeve, për të gjashta dokumentet e politikave konsultimi është shpallur në portal së bashku me dokumentet përkatëse shoqëruese. Vetëm në një rast, ABPRP 2025-2028, komentet janë mbledhur drejtpërdrejt përmes platformës. Për më tepër, raporti përfundimtar mbi procesin e konsultimit është publikuar në portal vetëm për katër procese: Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2025-2030; Strategjia e Integruar e Menaxhimit të Mbeturinave në Kosovë (2024-2035) dhe Plani i Veprimit (2024-2026); Programi për Zhvillim të Balancuar Rajonal 2025-

²⁷ Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2025-2030; Strategjia dhe Plani i Veprimit për Ndërhyrjen në Fëmijërinë e Hershme 2025-2030; Strategjia e Integruar e Menaxhimit të Mbeturinave në Kosovë (2024-2035) dhe Plani i Veprimit (2024-2026); Programi për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2025-2028; Programi për Zhvillim të Balancuar Rajonal 2025-2027; Programi i Pronësisë Industriale 2025-2027.


2027; dhe Programi i Pronësisë Industriale 2025-2027. Raporti për Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Ndërhyrjen në Fëmijërinë e Hershme 2025-2030 nuk është publikuar fare, ndërsa raporti përfundimtar i procesit të konsultimit për ABPRP 2025-2028 është publikuar vetëm në faqen e internetit të Qeverisë, por jo drejtpërdrejt në platformë. Vetëm platforma online e e-konsultimeve është përdorur për të informuar publikun lidhur me thirrjen për pjesëmarrje në procesin e konsultimit. Platformat e tjera, si faqja zyrtare e internetit, rrjetet sociale, mediat e shkruara dhe komunikimi përmes emailit, nuk janë shfrytëzuar.

I gjithë legjislacioni është publikisht i qasshëm, pa pagesë, në gazetën zyrtare. Legjislacioni primar dhe sekondar mund të gjendet përmes kërimit me fjalë kyçe, titull, datë, institucion, përmbajtje dhe lloj dokumenti, duke përdorur opsionin e Kërimit të Avancuar. Edhe versionet e konsoliduara janë të disponueshme për një numër të vogël aktesh, me të gjitha ndryshimet e integruara në aktin fillestar dhe të shënuara qartë. Megjithatë, ato janë të disponueshme vetëm në gjuhën shqipe.

Informatorët kyç të intervistuar lidhur me punën e grupeve punuese pasqyrojnë vlerësimin e deritanishëm. Të gjithë ata nuk pajtohen se ministrinë udhëheqëse marrin vendime dhe japin arsyetime bazuar në propozimet e shoqërisë civile. Po ashtu, të gjithë përveç njërit nuk pajtohen se vendimet dhe dokumentet që dolën si rezultat i procedurave të grupeve punuese ishin të qasshme për ta. Nga Anketa mbi Perceptimin Publik, 55.7% e qytetarëve mendojnë se kanë mundësi të marrin pjesë në hartimin e ligjeve dhe strategjive në Kosovë.

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?

Sub-indikatori 3: Transparenca dhe gjithëpërfshirja e procesit të hartimit të politikave dhe zhvillimit të legjislacionit (pikët maksimale 52)



II.4 Transparenca dhe gjithëpërfshirja e zbatimit të politikave, vlerësimit dhe mbikëqyrjes parlamentare.

Parimi 6: Politikat publike zbatohen dhe vlerësohen në mënyrë efektive, duke përmirësuar rezultatet e politikave dhe duke ulur kostot dhe barrët rregullatore.

Parimi 7: Kuvendi mbikëqyr në mënyrë efektive politikëbërjen e Qeverisë dhe siguron koherencën e përgjithshme të politikave dhe legjislacionit.

Pikët e dhëna për secilin element në sub-indikatorin 4: Transparenca dhe gjithëpërfshirja e zbatimit të politikave, vlerësimit dhe mbikëqyrjes parlamentare²⁸

Elementet e indikatorit	Lloji i Elementit	Pikët
E 4.1 Ekziston një dokument strategjik në fuqi që parasheh transparencën dhe gjithëpërfshirjen e praktikave të monitorimit dhe vlerësimit të politikave.	Strategji dhe Politike	0/0.5
E 4.2 Rregulloret parashohin dërgimin e njoftimeve paraprake tek grupet e prekura lidhur me ndryshimet e ardhshme në kornizën ligjore.	Legjislacioni	0/0.5
E 4.3 Rregullorja e Punës së Kuvendit parasheh pjesëmarrjen e palëve të interesit në diskutimet parlamentare, në formën e dëgjimeve publike.	Legjislacioni	0.5/0.5
E 4.4 Ministritë udhëheqëse publikojnë njoftime paraprake për grupet e prekura lidhur me ndryshimet e ardhshme në kornizën ligjore.	Praktika në zbatim	0/1.5
E 4.5 Ministritë udhëheqëse publikojnë rregullisht raporte monitorimi mbi zbatimin e dokumenteve të politikave.	Praktika në zbatim	0/2.5
E 4.6 Raportet e monitorimit mbi zbatimin e politikave janë të kuptueshme për qytetarët.	Praktika në zbatim	0.25/1.25
E 4.7 Ministritë udhëheqëse publikojnë vlerësime të nevojshme mbi zbatimin e politikave.	Praktika në zbatim	0/2.5

28 Sub-indikatori i katërt fokusohet në nën-parimet vijuese të SIGMA-s: Institucionet përgjegjëse monitorojnë në mënyrë efektive zbatimin e politikave dhe sigurojnë përputhshmërinë rregullatore, bazuar në të dhëna të qëndrueshme dhe relevante, përfshirë mbledhjen e dëshmive përmes reagimeve të drejtpërdrejta dhe konsultimeve me palët e prekura të interesit; Vlerësimi ex post i ligjeve dhe politikave kryesore është pjesë përbërëse e agjendës për rregullim më të mirë dhe lidhet me analizën e kryer gjatë zhvillimit të politikës. Administrata publike i bën rezultatet e vlerësimit publikisht të qasshme dhe i përdor ato për të informuar politikën e ardhshme; Bizneset dhe qytetarët njoftohen paraprakisht për ndryshimet e ardhshme në rregulla dhe rregullore që do të ndikojnë tek ata, dhe grupeve të prekura u jepet kohë e mjaftueshme për t'u përshtatur dhe harmonizuar me kornizën e re rregullatore; Komisionet parlamentare debatojnë dhe shqyrtojnë iniciativat legjislative, me pjesëmarrje aktive të ministrave të qeverisë dhe zyrtarëve të lartë publikë, si dhe sigurojnë konsultim me palët kryesore të interesit, duke minimizuar njëkohësisht çdo rrezik të ndikimit të padrejtë të jashtëm; Shërbimet parlamentare ofrojnë këshilla dhe mbështetje profesionale për deputetët në iniciimin dhe hartimin e ligjeve të reja, të bazuara në dëshmi dhe me kontribut nga palët kryesore të interesit.

E 4.8 Vlerësimet mbi zbatimin e politikave përdorin të dhëna dhe informacione të jashtme të prodhuara nga aktorë jo-shtetërorë.	Praktika në zbatim	0/2.5
E 4.9 Kuvendi përfshin palët e interesit, grupet e prekura dhe akterët të tjerë jo-shtetërorë në dëgjimet publike.	Praktika në zbatim	0/2.25
E 4.10 Transparenca online e punës së kuvendeve.	Praktika në zbatim	1/2
E 4.11 Akterët kryesorë jo-shtetërorë e konsiderojnë efektive përfshirjen e palëve të interesit në dëgjimet publike.	Rezultatid he ndikimi	0/3
Pikët totale të nën – indikatorit 4		1.75/19

Gjendja aktuale

Sub-indikatori 4 fokusohet në transparencën dhe gjithëpërfshirjen gjatë zbatimit të politikave, vlerësimit dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ai shqyrton nëse ekzistojnë korniza strategjike dhe ligjore që mundësojnë përfshirjen e palëve të interesit dhe se si këto zbatohen në praktikë nga institucionet përgjegjëse. Kjo përfshin verifikimin nëse publikohen njoftime paraprake për ndryshimet ligjore, nëse ka raportim të rregullt mbi zbatimin e politikave, nëse kryhen vlerësime paraprake dhe nëse përdoren të dhëna nga aktorë jo-shtetërorë. Gjithashtu, mbulon rolin e Kuvendit në sigurimin e transparencës përmes mekanizmave si dëgjimet publike dhe transparenca online, si dhe sa efektive perceptohen këto procese nga aktorët relevantë. Në Kosovë, ky sub-indikator është vlerësuar me 1.75 nga 19 pikë

Sub-indikatori 4, i cili mbulon transparencën dhe përfshirjen në zbatimin e politikave, vlerësimin dhe mbikëqyrjen parlamentare, në përgjithësi tregon performancë të dobët në praktikë. Kjo pasqyron mungesën e mekanizmave funksionale për transparencë dhe pjesëmarrje efektive.

Në praktikë, institucionet qeveritare, veçanërisht ministritë udhëheqëse, nuk publikojnë në mënyrë sistematike njoftime paraprake për ndryshimet ligjore apo raporte të rregullta mbi zbatimin e politikave. Gjithashtu, vlerësimet paraprake të politikave pothuajse mungojnë plotësisht dhe nuk bazohen në të dhëna të jashtme apo kontribut nga akterë jo-shtetërorë. Roli i Kuvendit në sigurimin e transparencës dhe përfshirjes është gjithashtu i kufizuar, ndërsa akterët jo-shtetërorë nuk e konsiderojnë pjesëmarrjen e tyre në proceset parlamentare si efektive. Për këto arsye, në përgjithësi, ky sub-indikator tregon mungesë të theksuar të praktikave funksionale gjatë ciklit të zbatimit dhe mbikëqyrjes së politikave.

Megjithatë, në nivel ligjor ekzistojnë rregulla që parashohin përfshirjen e palëve të interesit. Konkretisht, Neni 39 i Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës²⁹ mbi dëgjimet publike legjislative përcakton qartë se dëgjimet publike organizohen ndërmjet leximit të parë dhe të dytë të një projektligji.

²⁹ Rregullorja e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocument-Detail.aspx?ActID=61266&fbclid=IwAR2pkg1WSEcTI3ZFBSGCBpZ0Vh5lt7ysr9nvzgMndq-6nYhvjl-jBQF00qKQ>.


Kjo mundëson pjesëmarrje të gjerë të publikut, shoqërisë civile, komunitetit të biznesit dhe akterëve të tjerë. Gjithashtu, aty thuhet se dëgjimet publike janë të hapura për të gjithë dhe asnjë palë e interesuar nuk mund të përjashtohet për shkak të kufizimeve të kapacitetit fizik, duke kërkuar mënyra alternative për përfshirjen e kontributeve. Kjo tregon se në nivel ligjor ekziston një kornizë për pjesëmarrje në proceset parlamentare.

Megjithatë, gjatë vitit të fundit, situata politike në Kosovë ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin normal të institucioneve publike. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur një qeveri plotësisht funksionale dhe Kuvendi nuk ka qenë i konstituuar plotësisht, gjë që e ka kufizuar aftësinë e tij për të ushtruar detyrat e rregullta. Si rezultat, proceset kyçe institucionale që lidhen me transparencën, pjesëmarrjen dhe mbikëqyrjen e politikave janë ndërprerë ndjeshëm ose nuk janë zhvilluar siç pritej.

Për këtë arsye, edhe pse ekziston korniza ligjore për transparencë dhe përfshirje, ajo nuk ka mundur të zbatohet në praktikë në mënyrë domethënëse gjatë periudhës së monitorimit. Prandaj, ky element është vlerësuar me 0 pikë, duke reflektuar mungesën e zbatimit efektiv dhe jo mungesën e dispozitave ligjore.


Si qëndron Kosova në aspektin rajonal ?

Sub- indikator 4: Transparenca dhe gjithëpërfshirja e zbatimit të politikave, vlerësimit dhe mbikëqyrjes parlamentare (maksimumi i pikëve 19).



Krahasimi i pikëve të përgjithshme në fushën e Hartimit dhe Koordinimit të Politikave

Indikatori: Transparenca dhe gjithëpërfshirja e hartimit dhe koordinimit të politikave.



Raporti rajonal për fushën e Hartimit dhe Koordinimit të Politikave, me rezultatet për të gjitha administratat e Ballkanit Perëndimor, është i qasshëm në: www.par-monitor.org

II.5 Rekomandime për fushën e Zhvillimit dhe Koordinimit të Politikave

II.5.1 Ndjekja e rekomandimeve nga RAP Monitor 2021/2022

[paraqitje e thjeshtë tabelare e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme – statusi, me ngjyra sinjalizuese]

Rekomandimet	Lloji (afat-shkurtër / afatmesëm / afatgjatë)	Statusi	Shpjegimi
Raportimi vjetor i GAWP-it duhet të hartohet dhe publikohet në përputhje me kornizën ligjore.	Afatgjatë	Jo e implementuar	Qeveria vazhdon të shfaqë mangësi në këtë fushë edhe gjatë këtij cikli monitorimi.
Struktura e raporteve vjetore të GAWP-it duhet të përmirësohet për të përfshirë rezultate të dukshme në fusha të ndryshme të politikave, si barazia gjinore, mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, në përputhje me kornizën ligjore.	Afatmesëm	Jo e implementuar	Qeveria vazhdon të tregojë mangësi në këtë fushë edhe në këtë cikël monitorimi.
Institucionet publike, përfshirë Qeverinë, duhet t'i publikojnë raportet në format të dhënave të hapura, për të lehtësuar qasjen dhe përdorimin e tyre nga të gjitha palët e interesuara.	Afatmesëm	Jo e implementuar	Qeveria vazhdon të shfaqë mangësi në këtë fushë edhe gjatë këtij cikli monitorimi.
Qeveria duhet të krijojë praktikën e publikimit të rregullt paraprak të pikave të rendit të ditës para mbajtjes së seancave individuale të qeverisë, për të rritur transparencën dhe për t'u mundësuar palëve të interesuara përgatitje të duhur.	Afatshkurtë	Jo e implementuar	Qeveria vazhdon të mos i publikojë rendet e ditës paraprakisht para mbajtjes së seancave qeveritare.

Komunikatat për media duhet të publikohen ose të lidhen së bashku me materialet e tjera, në mënyrë që të gjitha informacionet nga seancat individuale të mund të gjenden dhe qasen në një faqe të vetme interneti.	Afatshkurtë	Jo e implementuar	Qeveria vazhdon të mos publikojë komunikata për media pas të gjitha mbledhjeve të qeverisë. Gjatë kësaj periudhe monitorimi, vetëm 2 nga 13 janë publikuar.
Ministritë dhe autoritetet e tjera publike duhet të vazhdojnë organizimin e konsultimeve publike (dhe debateve publike), si dhe të sigurojnë kohë dhe reagim të duhur në njoftimin e tyre. Kjo nënkupton që duhet të ndahet kohë e mjaftueshme për përgatitjen e shoqërisë civile dhe palëve të tjera të interesuara, si dhe të përdoren të gjitha kanalet në dispozicion për njoftimin e konsultimeve – përfshirë faqen e internetit të institucionit përgjegjës, Platformën për Konsultime Publike dhe rrjetet sociale të të gjitha institucioneve të përfshira.	Afatshkurtë	Pjesërisht e implementuar	

II.5.2 Rekomandime nga raporti monitorues 2024/2025

Rekomandimet nga cikli monitorues 2024/2025 për fushën e Zhvillimit dhe Koordinimit të Politikave janë paraqitur më poshtë. Rekomandimet janë grupuar në tri kategori, sipas kohës së vlerësuar të nevojshme për zbatimin e tyre. Rekomandimet për të cilat koha e vlerësuar e zbatimit është deri në një vit janë cilësuar si afatshkurtra. Rekomandimet afatmesme pritet të mund të zbatohen brenda një periudhe prej një deri në tre vjetësh. Rekomandimet afatgjata ka të ngjarë të kërkojnë më shumë se tre vjet për t'u zbatuar.

Rekomandimet afat-shkurta

- Të përmirësohet publikimi i dokumenteve kyçe të qeverisë në faqen zyrtare të Qeverisë.
- Të sigurohet që ligjet ekzistuese për transparencë dhe pjesëmarrje të zbatohen në praktikë.
- Të fillohet me publikimin më të rregullt të raporteve të zbatimit, edhe nëse kjo ende nuk është e rregulluar plotësisht.
- Të publikohen të gjitha pikat e rendit të ditës para seancave qeveritare, si dhe të sigurohet publikimi i procesverbaleve dhe komunikatave për media pas mbajtjes së tyre, edhe në rastet kur kjo nuk kërkohet shprehimisht me ligj.
- Të publikohen me kohë dhe në mënyrë të qasshme raportet dhe dokumentet

mbështetëse që lidhen me proceset e konsultimeve publike.

- Të forcohet komunikimi proaktiv për konsultimet publike përmes kanaleve dhe formateve të ndryshme të komunikimit, me qëllim të rritjes së vetëdijes dhe pjesëmarrjes së publikut.
- Të sigurohet që të gjitha vlerësimet ex-ante të ndikimit të përfshijnë në mënyrë sistematike edhe vlerësimin e ndikimit në barazinë gjinore për secilin dokument politikash dhe projektligj.

Rekomandimet afat - mesme

- Të zhvillohet një sistem i unifikuar për publikimin e të gjitha dokumenteve strategjike në një vend të vetëm.
- Të vendosen procedura më të qarta të brendshme për monitorimin dhe raportimin e zbatimit.
- Të përmirësohet koordinimi ndërmjet institucioneve për raportim të qëndrueshëm mbi planet dhe rezultatet.
- Të mundësohet dhe inkurajohet në mënyrë aktive pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile, aktorëve jo-shtetërorë dhe publikut më të gjerë në grupet punuese që lidhen me zhvillimin e politikave dhe legjislacionit.
- Të publikohen rregullisht raportet dhe përditësimet mbi punën dhe rezultatet e grupeve punuese të qeverisë, me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies.

Rekomandimet afat - gjata

- Të vendoset një obligim i fortë ligjor për raportim të rregullt dhe të standardizuar mbi të gjitha planet kyçe të qeverisë.
- Të centralizohen plotësisht të gjitha informacionet mbi planifikimin dhe raportimin qeveritar në një platformë të vetme digjitale.
- Të forcohet kultura institucionale e transparencës, llogaridhënies dhe zbatimit të qëndrueshëm të ligjit.
- Të ndryshohet dhe forcohet korniza ligjore për të kërkuar dhe rregulluar formalisht pjesëmarrjen e aktorëve jo-shtetërorë në grupet punuese të qeverisë.
- Të caktohet ose themelohet një institucion përgjegjës apo mekanizëm mbikëqyrës për monitorimin dhe verifikimin e respektimit të kërkesave për konsultime publike dhe standardeve të transparencës.

Shtojca e Metodologjisë

Për hartimin e këtij raporti për Kosovën, janë përdorur metodat dhe mjetet e më poshtme të hulumtimit për mbledhjen e të dhënave dhe llogaritjen e elementeve:

- Analiza e dokumentacionit zyrtar, të dhënave dhe faqeve zyrtare të internetit
- Kërkesa për qasje në dokumente publike/informata
- Intervista me palët e interesuara dhe informatorët kyç
- Anketë mbi perceptimin e publikut.

Monitorimi është mbështetur kryesisht në analizën e dokumenteve zyrtare të publikuara në faqet e internetit të organeve të administratës, si dhe në të dhënat dhe informacionet e përfshira në to. Megjithatë, në rastet kur të dhënat nuk ishin të disponueshme, hulumtuesit kanë dërguar kërkesa për qasje në informata tek institucionet përkatëse, me qëllim sigurimin e informacionit të nevojshëm për vlerësimin e elementeve me pikë.

Tabela X. Kërkesat për qasje në informata të dërguara në Kosovë

Institucioni	Data e kërkesës	Data e kthimit të kërkesës
Zyrja e Kryeministrit	24.12.2025	14.01.2026
Zyrja e Kryeministrit	25.03.2026	27.03.2026
Parlamenti i Republikës së Kosovës	19.12.2025	19.12.2025

Intervistat me informatorët kyç janë zhvilluar dhe janë përdorur si bazë për ndarjen e pikëve për elementet 1.5, 2.14, 3.14, 3.23 dhe 4.11. Përveç kësaj, ato janë përdorur për të mbledhur të dhëna cilësore, të fokusuara dhe të thelluara mbi fenomenet e monitoruara. Intervistat me palë të tjera të interesuara (si përfaqësues të organeve të administratës publike) janë përdorur gjithashtu në hulumtim për të plotësuar dhe verifikuar të dhënat dhe gjetjet e mbledhura në mënyra të tjera. Përzgjedhja e të intervistuarve është bazuar në mostrim të qëllimshëm, jo-probabilistik, duke synuar bashkëbisedues sipas ekspertizës së tyre mbi temën ose përfshirjes në proceset e vëzhguara.

Intervistat me informatorët kyç përbëheshin nga një grup prej deri në katër pyetjesh, ku pjesëmarrësit shprehnin pajtimin e tyre në një shkallë me katër nivele: nuk pajtohem fare, prirem të mos pajtohem, prirem të pajtohem dhe pajtohem plotësisht. Pikët për elementet 1.5, 2.14, 3.14, 3.23 dhe 4.11 janë ndarë vetëm në rastet kur të gjithë informatorët kyç deklarorin se priren të pajtohen ose pajtohen plotësisht me pohimin. Përveç kësaj, është përdorur edhe një grup pyetjesh të hapura, duke mundësuar diskutim me të intervistuarit dhe parashtrimin e nënpyetjeve në moment, në vend të ndjekjes strikte të një

formati të paracaktuar. Të intervistuarve u është garantuar anonimitet i plotë sa i përket të dhënave personale dhe përkatësisë institucionale/organizative.

Tabela X. Intervistat e zhvilluara në Kosovë

Data	Intervistat
5 Mars 2026	GLPS
11 Dhjetor 2025	GAP
11 Dhjetor 2025	INDEP

Lista e pyetjeve të intervistës

• Elementi 1.5

Pyetjet e mëposhtme përdoren për ndarjen e pikëve për elementin 1.5. Ndarja e pikëve përcaktohet bazuar në përgjigjet “pajtohem plotësisht/prirem të pajtohem”. Për secilën pyetje ku të gjithë informatorët kyç pajtohen plotësisht ose priren të pajtohen me pohimin, ndahen 0.75 pikë.

Deri në çfarë mase pajtoheni me pohimin e mëposhtëm: **Pikat e rendit të ditës për seancat e Qeverisë janë transparente.**

- a. nuk pajtohem aspak
 - b. prirem të mos pajtohem
 - c. prirem të pajtohem
 - d. plotësisht pajtohem
1. Deri në çfarë mase pajtoheni me pohimin e mëposhtëm: **Procesverbalet e seancave të Qeverisë janë transparente.**
 - a. nuk pajtohem aspak
 - b. prirem të mos pajtohem
 - c. prirem të pajtohem
 - d. plotësisht pajtohem
 2. Deri në çfarë mase pajtoheni me pohimin e mëposhtëm: **Vendimet nga seancat e Qeverisë janë transparente.**
 - a. nuk pajtohem aspak
 - b. prirem të mos pajtohem
 - c. prirem të pajtohem
 - d. plotësisht pajtohem
 3. Deri në çfarë mase pajtoheni me pohimin e mëposhtëm: **Qeveria informon publikisht për vendimet e saj përmes komunikatave për media.**
 - a. nuk pajtohem aspak
 - b. prirem të mos pajtohem
 - c. prirem të pajtohem
 - d. plotësisht pajtohem

Pyetje shtesë udhëzuese (nuk përdoren për ndarjen e pikëve, por janë relevante për ofrimin e njohurive cilësore të nevojshme për vlerësim):

1. Si bëhen zakonisht të njohura për publikun ose palët e interesuara pikat e rendit të ditës për seancat e Qeverisë?
2. Kush zakonisht ka qasje në pikat e rendit të ditës para mbajtjes së seancave dhe si ndikon kjo në transparencë ose pjesëmarrje?
3. Sa të dobishme janë procesverbalet ekzistuese të mbledhjeve për të kuptuar se si janë marrë vendimet? Gjithashtu, a kontribuon niveli aktual i transparencës së procesverbaleve në llogaridhënie?
4. A mendoni se vendimet e marra në seancat e Qeverisë paraqiten në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për publikun?
5. A ka lloje të vendimeve që janë më shumë ose më pak transparente se të tjerat? Nëse po, pse mendoni se ndodh kjo?
6. Si do ta përshkruanit tonin dhe nivelin e detajeve të komunikatave për media të Qeverisë — a janë ato informuese, selektive apo të përgjithshme?
7. A mendoni se komunikatat për media pasqyrojnë përmbajtjen dhe arsyetimin real të vendimeve të Qeverisë?
8. Sipas mendimit tuaj, si duhet të duket një proces plotësisht transparent dhe llogaridhënës i vendimmarrjes qeveritare?

• Elementi 2.14

Pyetjet e mëposhtme përdoren për ndarjen e pikëve për elementin 2.14. Ndarja e pikëve përcaktohet bazuar në përgjigjet “pajtohem plotësisht/prirem të pajtohem”. Për secilën pyetje ku të gjithë informatorët kyç pajtohen plotësisht ose priren të pajtohen me pohimin, ndahet 1 pikë.

1. Deri në çfarë mase pajtoheni me pohimin e mëposhtëm: **Aktivitetet e planifikimit dhe raportimit të Qeverisë janë transparente.**
 - a. nuk pajtohem aspak
 - b. prirem të mos pajtohem
 - c. prirem të pajtohem
 - d. plotësisht pajtohem
2. Deri në çfarë mase pajtoheni me pohimin e mëposhtëm: **Aktivitetet e planifikimit dhe raportimit të Qeverisë realizohen me kohë.**
 - a. nuk pajtohem aspak
 - b. prirem të mos pajtohem
 - c. prirem të pajtohem
 - d. plotësisht pajtohem
3. Deri në çfarë mase pajtoheni me pohimin e mëposhtëm: **Aktivitetet e planifikimit dhe raportimit të Qeverisë janë të kuptueshme dhe të qasshme për qytetarët.**

- a. nuk pajtohem aspak
- b. prirem të mos pajtohem
- c. prirem të pajtohem
- d. plotësisht pajtohem

Pyetje shtesë udhëzuese (nuk përdoren për ndarjen e pikëve, por janë relevante për ofrimin e njohurive cilësore të nevojshme për vlerësim):

1. A i shpjegojnë dhe paraqesin qartë dokumentet e planifikimit të Qeverisë prioritetet, objektivat dhe rezultatet e pritshme të Qeverisë?
2. A ekzistojnë mundësi që palët e jashtme të interesuara ose publiku të japin kontribut gjatë fazës së planifikimit? A ndryshon kjo praktikë ndërmjet dokumenteve të ndryshme të planifikimit?
3. Sa i përket afateve kohore, a ekzistojnë mekanizma që sigurojnë respektimin e cikleve të planifikimit dhe raportimit dhe harmonizimin e tyre me ciklet buxhetore ose të politikave?
4. A mund të kujtoni një rast kur afatet kohore të raportimit (ose mungesa e tyre) kanë ndikuar në ndjekjen e politikave ose në llogaridhënie?
5. Sa efektivisht e komunikon Qeveria për qytetarët rezultatet e planifikimit dhe raportimit të saj, në aspektin e përcjelljes së mesazheve dhe rezultateve kryesore? Si e vlerësoni vetëdijen ose interesimin e qytetarëve për këto dokumente?

• Elementi 3.23

Pyetjet e mëposhtme përdoren për ndarjen e pikëve për elementin 3.23. Ndarja e pikëve përcaktohet bazuar në përgjigjet “pajtohem plotësisht/prirem të pajtohem”. Për secilën pyetje ku të gjithë informatorët kyç pajtohen plotësisht ose priren të pajtohen me pohimin, ndahet 1 pikë.

1. Deri në çfarë mase pajtoheni me pohimin e mëposhtëm: **Në punën e grupeve punuese, ministritë udhëheqëse vendosin për propozimet e mia/propozimet e organizatës sime (i pranojnë ose i refuzojnë ato).**
 - a. nuk pajtohem aspak
 - b. prirem të mos pajtohem
 - c. prirem të pajtohem
 - d. plotësisht pajtohem
2. Deri në çfarë mase pajtoheni me pohimin e mëposhtëm: **Në punën e grupeve punuese, ministritë udhëheqëse ofrojnë arsyeime për vendimet lidhur me pranimin ose refuzimin e propozimeve të mia/propozimeve të organizatës sime.**
 - a. nuk pajtohem aspak
 - b. prirem të mos pajtohem
 - c. prirem të pajtohem
 - d. plotësisht pajtohem

3. Deri në çfarë mase pajtoheni me pohimin e mëposhtëm: **Në punën e grupeve punuese, vendimet dhe dokumentet që dalin si rezultat i punës së grupeve punuese janë të qasshme për mua/organizatën time.**
 - a. nuk pajtohem aspak
 - b. prirem të mos pajtohem
 - c. prirem të pajtohem
 - d. plotësisht pajtohem

Pyetje shtesë udhëzuese (nuk përdoren për ndarjen e pikëve, por janë relevante për ofrimin e njohurive cilësore të nevojshme për vlerësim):

1. Duke reflektuar mbi përvojën tuaj në pjesëmarrjen në grupet punuese, si do ta përshkruanit atmosferën dhe dinamikën e përgjithshme të bashkëpunimit?
2. Cili ishte zakonisht procesi pasi dorëzonit një propozim — si regjistrohej ose ndiqej ai më tej?
3. A mund të kujtoni shembuj të propozimeve që janë pranuar dhe të tjera që nuk janë pranuar? Nëse ka pasur raste kur propozimet tuaja janë refuzuar, a mund të identifikoni nëse arsyet e refuzimit zakonisht lidhen me prioritetet e politikave, kufizimet ligjore apo faktorë të tjerë?
4. A keni ndier se kontributi juaj është trajtuar në mënyrë të barabartë me kontributet e ofruara nga përfaqësuesit e institucioneve qeveritare?
5. A keni vërejtur se ministria/institucioni udhëheqës ishte i hapur ndaj perspektivave alternative ose komenteve kritike?
6. A kishte tema ose çështje ku diskutimi dukej më pak i hapur ose i paracaktuar?
7. Sa u përket vendimeve dhe rezultateve të grupit punues, kur zakonisht i pranoni dokumentet (projektligjet/dokumentet e politikave, procesverbalet e mbledhjeve, materialet përgatitore, përfundimet etj.): gjatë procesit, pas çdo mbledhjeje apo vetëm pasi publikohet produkti përfundimtar?
8. A ishin dokumentet mjaftueshëm të qarta për të kuptuar se si janë reflektuar kontributet e ndryshme në versionin përfundimtar?
9. Sipas mendimit tuaj, çfarë e dallon një grup punues vërtet gjithëpërfshirës nga një grup që është vetëm formalisht gjithëpërfshirës?

• Elementi 4.11

Pyetjet e mëposhtme përdoren për ndarjen e pikëve për elementin 4.11. Ndarja e pikëve përcaktohet bazuar në përgjigjet “pajtohem plotësisht/prirem të pajtohem”. Nëse të gjithë informatorët kyç pajtohen plotësisht ose priren të pajtohen me pohimin, ndahen 3 pikë.

1. Deri në çfarë mase pajtoheni me pohimin e mëposhtëm: **Gjatë dëgjimeve publike, komisionet parlamentare i marrin parasysh propozimet e mia/propozimet e organizatës sime.**

- a. nuk pajtohem aspak
- b. prirem të mos pajtohem
- c. prirem të pajtohem
- d. plotësisht pajtohem

Pyetje shtesë udhëzuese (nuk përdoren për ndarjen e pikëve, por janë relevante për ofrimin e njohurive cilësore të nevojshme për vlerësim):

1. Sa shpesh keni marrë pjesë ju ose organizata juaj në dëgjime të tilla dhe në cilat fusha të politikave?
2. Nga përvoja juaj, a kanë të gjithë pjesëmarrësit mundësi të barabarta për të shprehur mendimet e tyre?
3. Kur ju ose organizata juaj keni dorëzuar komente ose rekomandime, si janë pranuar dhe trajtuar ato nga anëtarët e komisionit?
4. Pas një dëgjimi, a merrni ndonjë informacion pasues mbi mënyrën se si janë trajtuar kontributet tuaja?
5. A mendoni se mekanizmat aktualë të kthimit të përgjigjeve (feedback-ut) janë të mjaftueshëm për të siguruar llogaridhënien e komisioneve parlamentare?

Anketa mbi perceptimin e publikut bazohet në një pyetësor që synon publikun e përgjithshëm (banorët e përhershëm 18+) të Kosovës. Anketa është realizuar përmes intervistimit telefonik të asistuar me kompjuter (CATI), në kombinim me intervistimin online të asistuar me kompjuter (CAWI).

Anketa është zhvilluar nga 1 deri më 26 shkurt 2025. Marzhi i gabimit për mostrën prej 1007 qytetarësh është $\pm 3.5\%$, me nivel besueshmërie prej 95%.

Tabela X: Pyetjet e anketës mbi perceptimin e publikut në fushën e Zhvillimit dhe Koordinimit të Politikave

Deklarata 1	Nuk pastohem aspak	Prirem të mos pajtohem	Prirem të pajtohem	Plotësisht pajtohem	Nuk e di / Nuk kam opinion
Unë kam mundësi të marr pjesë në hartimin e ligjeve dhe strategjive të Kosovës.	15.2	25.4	44	11.7	3.7

Lista e Referencave në Këtë Raport

Strategjia për Reformën e Administratës Publike 2022–2027. Qeveria e Kosovës. <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/01/PUBLIC-ADMINISTRATION-REFORM-STRATEGY-2022-2027.pdf>.

Rishikimi i Planit të Veprimit për Strategjinë e Reformës së Administratës Publike 2025–2027. Qeveria e Kosovës <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/EN/5050/FINAL%20ANG%20PV%20SRAP%202025-2027%20pdf.pdf>.

Rregullorja (QRK) Nr. 17/2024 për Rregullat e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës. Gazeta Zyrtare e Kosovës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=92322>.

Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave (SPPKP) 2022–2027. Qeveria e Kosovës. <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/4909/STRATEGJIA-E-REFORMES-SE-ADMINISTRATES-PUBLIKE-2022-2027.pdf>.

Ligji Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Gazeta Zyrtare e Kosovës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=66686>.

Rregullorja (QRK) Nr. 17/2024 për Punën e Qeverisë. Gazeta Zyrtare e Kosovës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=92322>.

Programi i Qeverisë së Kosovës 2021–2025. Qeveria e Kosovës. <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/06/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>.

Plani Kombëtar për Zhvillim (PKZH) 2024–2026. Qeveria e Kosovës. <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/01/PKZH-2024-2026.pdf>.

Raporti për Zbatimin e Programit për Integrim Evropian për periudhën janar-shtator 2024. Zyra e Kryeministrit. <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/01/Raport-mbi-zbatimin-e-PKIE-janar-shtator-2024.pdf>.

Manuali për Hartimin e Koncept Dokumentit. Zyra e Kryeministrit. https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Udhezuesi-dhe-Doracaku-per-Hartimin-e-Koncept-Dokumente-Shq-24-05-18_Publish.pdf.

Rregullorja e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61266&fbclid=IwAR2pkg1WSEcTI3ZFBSCCbPzOVh5lt7ysr9nvzgMndq-6nYhvjljBQF00qKQ>.

Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2025–2030. Qeveria e Kosovës.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Ndërhyrjen në Fëmijërinë e Hershme 2025–2030. Qeveria e Kosovës.

Strategjia e Integruar e Menaxhimit të Mbeturisë në Kosovë (2024–2035) dhe Plani i Veprimit (2024–2026). Qeveria e Kosovës.

Programi për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2025–2028. Qeveria e Kosovës.

Programi për Zhvillim të Balancuar Rajonal 2025–2027. Qeveria e Kosovës.

Programi për Pronësinë Industriale 2025–2027. Qeveria e Kosovës.



Funded by
the European Union

With funding from
 Austrian
Development
Agency

Produced within Western Balkan Enablers for Reforming Public Administrations – WeBER 3.0 project. WeBER 3.0 is implemented by Think of Europe Network - TEN and Centre for Public Administration Research – KDZ.

WeBER 3.0 is funded by the European Union and the Austrian Development Agency - ADA. Views and opinions expressed are however those of the authors only and do not necessarily reflect those of the European Union or ADA. Neither the European Union, ADA, TEN nor KDZ can be held responsible for them.

For more information, please visit www.par-monitor.org.